

Frrok KRISTAJ
ARTI I DIALOGUT
(Intervista me dr. don Lush Gjergjin)

Për botuesin
Atë NDUE KAJTAZI

Redaktor
Prend BUZHALA

Recensentë
Xhavit BEQIRI
Ndue UKAJ

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Frrok KRISTAJ

ARTI I DIALOGUT **(Intervista me dr. don Lush Gjergjin)**

Në 1700-vjetorin e legalizimit të krishterimit në botë
dhe në 40-vjetorin e meshtarisë së don Lushit

**ULKK
Prishtinë
2013**

Foto: Dr. don Lush Gjergji me autorin e librit

PËRMBAJTJA

Dr. don Lush GJERGJI: Kosova model për Mesdheun, Evropën dhe botën

Frrok Kristaj “Kosova model për Mesdheun, Evropën dhe botën”, Rilindja, Prishtinë, 13 janar 2000, faqe 7

Dr. don Lush GJERGJI: “Nëna Tereze” - sofër e mbrojtjes së dinjitetit të popullit tonë ...

Frrok Kristaj “Nëna Tereze” - sofër e mbrojtjes së dinjitetit të popullit tonë”, Rilindja, Prishtinë, 29 shkurt 2000 faqe 7

Dr. don Lush GJERGJI: Ta mësojmë artin e dialogut

Frrok Kristaj “Ta mësojmë artin e dialogut”, “Rilindja”, Prishtinë, 27 janar 2001, faqe 18

Dr. don Lush GJERGJI: Katedralja në Prishtinë ndriçon shekujt

Frrok Kristaj “Katedralja në Prishtinë ndriçon shekujt”, “Rilindja”, Prishtinë, 7 mars 2001, faqe 18

Dr. don Lush GJERGJI: Me tempullin e paqes në Prishtinë, bota do të jetë në Kosovë për të punuar si në një filialë të Kombeve të Bashkuara

Frrok Kristaj - Rexhep Demiri: “Me tempullin e paqes në Prishtinë, bota do të jetë në Kosovë për të punuar si në një filialë të Kombeve të Bashkuara”, Bota sot, Prishtinë, 9 dhjetor 2003, faqe 7

Dr. don Lush GJERGJI: Papa Gjon Pali II - dashamir i shqiptarëve

Frrok Kristaj “Papa Gjon Pali II - dashamir i shqiptarëve”, Bota sot, Prishtinë, 9 prill 2005, faqe 6 e 7

Dr. don Lush GJERGJI: Ambasador i kulturës shqiptare

Frrok Kristaj “Ambasador i kulturës shqiptare”, Rilindja, Prishtinë

Dr. don Lush GJERGJI: Vëllezëria jonë e dyfishtë është unike në botë

Frrok Kristaj “Vëllezëria jonë e dyfishtë është unike në botë”, Bota sot, Prishtinë, 27 maj 2011, faqe 12

BIOGRAFIA

PAK FJALË NË VEND TË PARATHËNIES

1700-vjetori i EDIKTIT TË MILANOS (313), përkatësisht jubile ky i legalizimit të krishterimit në botë, që e bëri njeriu i gjakut tonë - Perandorit dardan Konstandini i Madh, paraqet kthesë të madh, sepse shpreh tabanin e identitetit tonë kombëtar e fetar, që edhe sot e njuh bota.

Për të dëshmuar në vijimësi një identitet të këtij sivjet shënojmë edhe 40-vjetorin e meshtarisë dhe të atdhetarisë të meshtarëve të devotshëm të dr. don Lush Gjergjit, don Aleksandër Kolës e të don Ndue Gjergjit.

Kësaj radhe do të ndalemi te dr. don Lush Gjergji, jo pse ai është më i rëndësishëm nga dy të parët (don Aleksandër Kola shërbeu edhe si ambasador (misionar) i Kishës Shqiptare të Kosovës në Zvicër, përkatësisht don Ndue Gjergji po ashtu edhe sot është një ambasador i Kishës Shqiptare të Kosovës në SHBA), por se dr. don Lush Gjergji përherë ka shërbyer pa asnjë ndërprerje në Kosovë, që do të thotë se i ka përjetuar travajimet e popullit tonë, për çka edhe iu imponua që shumë herë të dal në ballë të mbrojtjes së idealeve të popullit shqiptar.

Në fakt, dr. don Lush Gjergji është njëri nga intelektualët tonë që ka bërë emër në të gjitha viset shqiptare, në diasporë, por edhe te popujt tjerë të Evropës e më gjerë. Ai është nga personalitetet më të çmuara ndër shqiptarë e më gjerë. Deri më tash ka kontribuar në disa fusha të jetës e të dijes. Përveç që është çmuar në misionin meshtarak, për çka edhe është shkolluar, është dalluar sidomos në misionin humanitar e fisnik, në pajtimin e gjaqeve e atë të peshës së fjalës së gjallë, që e bëri të dalluar me aftësitë oratoriale e njerëzore, që i preku majat e ndërgjegjës së njerëzimit.

Bile, e kam takuar edhe në predikimin e vlerave universale, siç janë: dashuria, paqja, liria... Sipas shkrimtarit, kritikut, publicistit e veprimtarit të devotshëm - Prend Buzhalës (“Res public e shkrimtarit”, Klubi i shkrimtarëve “Vorea Ujko”, Klinë, 2008, faqe 127-128), dr. don Lush Gjergji është dalluar për afri, tolerancë ndërfaqetare, ndërfaqetare e ndërnacionale, është angazhuar për respektimin e dallimeve ndërmjet njerëzve, por mbi të gjitha është angazhuar në çarqet ndërkombëtare për mbrojtjen e çështjes së Kosovës.

Por, dr. don Lush Gjergji krahas virtyteve që i përmenda, është edhe njeri i penës. Deri më tash ka botuar **60** vepra të nduarndurta, vepra këto që i janë përkthyer në 34 gjuhë botërore.

Ja, pra, pse unë herë pas here edhe kuvendova (e intervistova) me dr. don Lush Gjergjin, intervista këto që po ia sjelli lexuesit tonë në këtë libër, që botohet në frymën e dy jubileve që i përmenda në fillim.

Autori

KUSH ËSHTË DR. DON LUSH GJERGJI

Dr. don Lush Gjergji, prift katolik shqiptar i Ipeshkvisë së Kosovës, u lind në Stubëll të Epërme të Vitisë, më 21 mars 1949. Katër klasët e para të shkollës fillore i kreu në vendlindje, klasën e pestë në Viti, kurse tri klasët e fundit në Zhegër. Gjimnazin klasik e kreu në Dubrovnik, vitin e parë të filozofisë në Split, ndërsa vitet tjera dhe magistraturën (në filozofi) në Romë. Po ashtu, në Romë ka diplomuar teologjinë, si dhe në universitetin shtetëror të Romës “La Sapienza” ka studiuar dhe ka doktoruar në psikologji në vitin 1975. Dr. don Lush Gjergji ka shërbyer në Ferizaj, në Binçë, në Prizren dhe tash është vikar i Ipeshkvisë së Kosovës në Prishtinë. Vite me rradhë ishte redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetaro-kulturore e i shtëpisë botuese “Drita” me seli në Ferizaj e tash në nivel të Ipeshkvisë. Është njohës i gjuhës së vjetër latine, i gjuhës së vjetër greke, i gjuhës italiane, gjermane, frenge, angleze dhe i gjuhëve sllave që fliten në Ballkan. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtar i Gazetarëve dhe Publicistëve Katolik të Evropës dhe anëtar i Akademisë Evropiane.

Deri më tash ka botuar **60** vepra, shumica prej të cilave janë përkthyer në më se 35 gjuhë botërore.

Ka botuar këto vepra:

Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri (1977, 1990)

Krishti ndër ne (katekizëm, 1978, 1991)

Nëna jonë Tereze (1980,1990); vepra është botuar edhe kroatisht (1982, 1990), sllovenisht (1993), italisht (1993), frëngjisht (1995), spanjisht (1988), hungarisht (1990), anglisht (1992)

Kah toka e premtuar (katekizëm, 1985, 1991)

Zoti kujdeset për popull (katekizëm, 1985, 1991)

Lule për Nënë (monografi kushtuar Nënës Tereze - shqipe në vitin 1986), italisht (1989)

Krishti me ne (katekizëm, 1988, 1991)

Dashuria në vepër - Nëna Tereze (1992, 2010)

Fitorja e Kryqit (1992)

Dëshmitarët e Krishtit (katekizëm, 1992)

Shna Ndou - shenjt i botës (1995)

Atenagora - profet i bashkimit (1995), ribotimi në Sh.B. “55” në Tiranë (2000)

Jezusi ndërron jetën tonë (1997)

Zëri i heshtjes (1997)

Gonxhja jonë - Nëna e botës (1998)

Nëna e dashurisë (2000 e 2011)

Gonxhe Bojaxhiu - Nënë Tereza, poezi dhe uratë (zgjedhi: Dr. don Lush Gjergji (1998, 2000, 2003)

Zbulimi i Zotit dhurata më e çmuar (2002)

Prej dashurisë në dashuri (2005)

I pavdekshmi Gjon Pali II (2006)
Dashuria nuk dashurohet (2006)
Shën Pali - apostulli i popujve (2009)
Imzot Nikë Prela, njeriu i Zotit, Kishës dhe popullit (2010)
Shenjtëresha e dashurisë - Nëna Tereze (2010)
Të ftuar dhe të dërguar (2012).

Në gjuhën italishte:

La donna albanese (disertacioni i doktoranturës në psikologjinë shoqërore, 1975)
Tutta la nostra vita è dire “grazie” e “perdono” (1989, 2003, 2006)
Madre della carità, dy vëllime (1990; çdo vit disa ribotime). Vepra është botuar edhe anglisht (1991), spanjisht (1992), frëngjisht (1993), polakisht (1994), gjermanisht (1995), shqip (2000; 2011), kroatisht (2007), sllovenisht (2008)
Vivere, amare, testimoniare (La spiritualità di Madre Teresa), dy vëllime, 1995, botimi anglisht (1998), polakisht (1999)
Resistenza nonviolenta nel Kosovo (1993, 1996)
Non potete costringerci ad odiare (1996)
Kosovo, un popolo che perdona (1997)
Kosovo un popolo per la riconciliazione (1999)
L'amore che non muore, dy vëllime (1998, 2009)
Kosovo non violenza per la riconciliazione (1999)
Madre Teresa, l'amore in azione (2002, 2003), polakisht (2002, 2003, 2009), litvanisht (2003), anglisht (2008)
Sant'Antonio, il santo del mondo (2006), sllovenisht (2008), anglisht (2009)
Un santo per tutti, Sant'Antonio, 2010
La santa dell'amore - Madre Teresa (2010), italisht, 2009, anglisht (2010), polonisht (2010), rumanisht (2010)
Nikë Prela, uomo di Dio, della Chiesa e del popolo (2010)
Do përmendur se veprat e dr. don Lush Gjergjit “**Resistenza nonviolenta nel Kosovo**” (1993, 1996), “**Non potete costringerci ad odiare**” (1996), “**Kosovo, un popolo che perdona**” (1997), “**L'amore che non muore**” (dy vëllime 1998) dhe “**Kosovo non violenza per la riconciliazione**” (1999), të botuara në Itali, janë edhe literaturë plotësuese e lekturës për shkollat e mesme në Itali.

Në gjuhën kroate:

Majka Terezija (1982, 1990)
Život je naš hvala i oprost (1984, 1986), italisht (1989, 2003, 2006)
Živjeti ljubiti sluziti (1987)
Pjevaj i putuj (1988)
Glas šutnje (1990)
Pobjeda križa (1995)
Ljubav na djelu: Majka Terezija (1995)
Ljubav nije ljubljena (1995)
Živjeti s Kristom (1997)
Ljubiti s Marijom (1997)
Svjedočiti s Crkvom (1998)
Zraka Božje ljubavi (1998)
Pozvani na zajedništvo (2001)

Majka Terezija, Bog ljubi danas preko nas, pjesme i molitve, Priredio i preveo:

Lush Gjergji, 2003, sllovenisht (2009)

Majka ljubavi (2007)

Velikani XX. stoljeća. Ljubav koja ne umire (2007)

Dr. don LUSH GJERGJI

KOSOVA MODEL PËR MESDHEUN, EVROPËN DHE BOTËN

Të pyetemi se ç'bënë të tjerët, por ç'bëmë edhe në histori. Amerika është në Kosovë, Evropa është në Kosovë. E kemi lashtësinë, traditën, rrënjët dhe burimet. Gjatë 2000 vjetëve, më se 1300 sish (vjet) ishim nën sundim të të huajve dhe i kaluam ndër martirizime. Jemi të krishterë e myslimanë dhe nuk jemi në antagonizëm. Feja nuk ndan dhe nuk përçan, por ofron, bashkon dhe krijon bashkësi, krijon ndjenja të përbashkëta për ne bijtë e bijat e Zotit. Bota do të shohë se në një botë të vogël, siç është ajo shqiptare, ndodhë diçka e madhe dhe e mrekullueshme edhe për botën. Aq sa dimë të flijohemi dhe të ndihmojmë të tjerët, aq i ndihmojmë vetvetes dhe e mëshirojmë Zotin të na ndihmojë ne

Në ditën e parë të vitit 2000, përkatësisht në hapërim në mileniumin e tretë, për shumëçka, veçmas për çështjen shqiptare, me theks të veçantë të shqiptarëve të Kosovës, nga shumë aspekte zhvilluan një bisedë spontane me dr. don Lush Gjergjin, famullitar i Kishës shën Antoni (Shën Ndou), në Binçë të Vitisë së Kosovës, që njëherësh është edhe autor i mbi 40 veprave të botuara, disa nga të cilat janë të përkthyer në 24 gjuhë të botës.

Serbizimi - vampirizëm i së keqes

Don Lush Gjergji që në fillim të bisedës, ndër të tjera, tha se ndërrimi i motive duhet të jetë shkas që ne si shoqëri të bëjmë një lloj analize, një lloj vetanalize se çka kemi arritur dhe çka është dashur të arrijmë deri më tani. Mendoj se shekulli XX për shqiptarët ishte shumë i rëndësishëm për shumëçka, në rend të parë se përse u krijua një mënyrë shteti shqiptar, edhe pse ai shtet nuk ishte ai që dëshiroam dhe çka ishte dhe është nevojë e popullit shqiptar. Do përmendur se ky shkekull lidhet edhe me shumë personalitete shqiptare që i dhanë vetvetes dhe botës.

Po, nëse bëhet një sintezë e gjithë asaj se kush kemi qenë, kush jemi dhe kush duhet të jemi, atëherë ky shekull ishte shekulli i rreziqeve të mëdha për shqiptarët, sepse në skenë patën ardhur popujt e mëdhenj, të fuqishëm, popuj që ekonomkisht edhe ushtarakisht kanë pasur mundësi të ndajnë “drejtësinë”. Pikërisht për këtë ishin të copëtuar, të anësuar dhe në fund të shekullit gati rrezikuam edhe vetekzistencën e qenies sonë. Së paku një pjesë e madhe e popullit tonë, si në trazirat që ndodhën në Shqipëri, në vitin 1997, që ishte një çrregullim i tërësishëm i saj, çka duhej të ishte demokraci, që u shndërrua në anarki dhe vëllavrasje, sikurse edhe sundimi disadekadash serbosllav që na solli deri te gryka e humnerës, apo gryka e varrit. Dhe, vërtet, para pesë gjashtë muajsh, pyetja e çdo shqiptari ishte se a do të mbijetojmë. Ndërsa, fatbardhësisht përfundimi ishte sikur një lloj drame kur ndërhyrja “**Deux ex machina**”, një ndërhyrje e

jashtëzakonshme hyjnore që ndërron çdo gjë. Mu për këtë edhe sot Kosova, por jo vetëm Kosova, por populli shqiptar në tërësi, e ka një mundësi dhe ardhmëri, sepse në këtë periudhë u dëshmuua se Zoti është në anën e të mirit, të drejtës dhe të vërtetës. Fundja, Zoti kurrë nuk dështon, andaj nuk dështoi as në rastin e popullit shqiptar të Kosovës. Nga kjo del se vuajtja e flijimi është një kapital, të cilin duhet ta ruajmë edhe duhet ta çmojmë. Ai kapital na nxjerr edhe prej humnerës së varrit, prej vdekjes na bënë të ringjallemi. Përpos elementit hyjnor, Zoti e pat dorën e vet mbi ne dhe nuk lejoi që të shkatërrohemi dhe të asgjesohemi.

Mrekullia tjetër, përpos ajo e Zotit është mrekullia e Aleancës më të fuqishme botërore, e cila e sheh të arsyeshme dhe ndërhyr për herë të parë në Evropë. Për herë të parë në historinë botërore krijohet një aleancë e të mirëve, e të fortëve kundër të keqes, sepse e keqja dëshironte për dy arsye shumë të thjeshta të na asgjesonte, pse ishim shqiptarë dhe pse ishim gjallë. Serbizmi si vampirizëm i së keqes, u mundua në çdo mënyrë të na asgjesonte së fundi me armë, edhe me përndjekje, edhe me vrasje, me masakrime, me diegie, me dhunime etj. Mu për këtë populli shqiptar duhet të ndalet dhe të mendojë, se si e gjithë kjo që ka ndodhur është sikur ëndërr, si një film i shpejtuar para syjeve tanë, një histori e tashme, nga e cila duhet të mësojmë shumëçka.

Ta gjejmë apo rigjejmë vetveten

Në radhë të parë duhet të mbështetemi në vlera gjithënjëzore dhe gjithëshqiptare, në mënyrë që e tashmja dhe e ardhmja të kenë perspektivë. Duhet ta argumentojmë ndërhyrjen ushtarake, ta kërkojmë ndërhyrjen ekonomike, politike, kulturore, shoqërore, që për ne është fisnikërim e lartësim, që mundëson ngritjen e një Kosove model për Mesdheun, Evropën dhe botën. Vetëm atëherë mund të themi se ndërhyrja e bashkësisë ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ynë me ta (faktorin ndërkombëtar) dhe me Zotin ka dhënë rezultate. Është vendimtare për ne shqiptarët që të dijmë të bashkëpunojmë me Zotin, me bashkësinë ndërkombëtare dhe fundi-fundit, të dijmë të bashkëpunojmë mes veti, sepse ne, përderisa nuk i kthehemi vetvetës dhe së vërtetëtës është i kotë kthimi ynë tokave tona apo shtëpive tona, qenë ato të djegura apo pjesërisht të dëmtuara. Kthimi më i madh dhe rrënjësor është pikërisht, ta gjejmë apo rigjejmë vetëvetën.

Në anën tjetër, në këtë prizëm të 2000-vjetorit të krishterimit duhet të shikojmë se çka është historia jonë, kurse në prizëmën e fakteve, çka ka ndodhur me ne dhe pse ka ndodhur me ne.

Asnjë nuk është e rastit. Historia nuk njihet raste. Fundja, historia është lidhmëria e fakteve dhe faktorëve që ndërhyjnë në momentet e caktuara dhe japin dukuri të caktuara. Për këtë duhet të bëjmë një lloj rrënimi të ndërgjegjes, një lloj shqyrtimi për ta kuptuar dhe njohur vetveten.

Sot, shqiptarët ndodhen para luhatjes. Ne kemi regres në histori. Shpeshherë e kemi fajësuar çdo kë, bile edhe Zotin edhe botën, që nuk na kanë kuptuar, duke mos e fajësuar vetveten. Ky është një lloj infantilizmi politik, kulturor e shoqëror. Kemi vepruar si fëmija që nuk sheh kurrëfarë gabimi të vet, gjithmonë fajin ia lë tjetër kujt. Ky lloj infantilizmi që u dëshmuua tash edhe te serbët, se vetëm ata janë të pagabueshëm, se ndaj tyre mbarë bota gabon etj., u dëshmuua se ku i solli dhe ku janë sot serbët.

Ne nuk guxojmë vetëm të jemi kritik. Duhet të jemi edhe vetëkritik. Pra, të bëjmë një analizë historike, të shkruajmë një histori, e cila bazohet në një faktologji pa e injoruar asnjë moment dhe pa bërë histori selektive. Të tregojmë se ç'bënë të tjerët, por ç'bëmë edhe ne në histori. Edhe ne, nuk jemi pa lëshime e gabime. Kemi pasur dobësi, por kemi edhe tash. Është mirë që lëshimet sa më parë t'i njohim dhe t'i pranojmë, aq më lehtë do t'i eliminojmë dhe përmirësojmë. Gabimi tjetër yni është se ne ëndërrojmë syçeltas. Presim që Zoti dhe bashkësia

ndërkombëtare të bëjnë mrekulli mbi ne. Kështu nuk krijohet e tashmja e mirëfilltë dhe e ardhmja jonë.

Ne duhet t'i kthehemi të sotmes këtu, e tani duhet të përcaktohemi pikërisht në bazë të historisë, në bazë të elementeve që duhet t'i vlerësojmë sipas konfiguracionit ndërkombëtar, në të cilin jetojmë dhe jemi sidomos tash, brenda kornizës së bashkësisë ndërkombëtare, sepse Amerika nuk është më në Amerikë, por është në Kosovë, Evropa nuk është më në Evropë, por është në Kosovë. Ndaj, pikërisht këtu duhet ta gjejmë gërshetimin dhe këtu duhet ta gjejmë mundësinë që me ato vlera me të cilat në një mënyrë edhe iu imponuam faktorit ndërkombëtar të ndërhyjë këtu. Bashkësinë ndërkombëtare duhet ta bindim se jemi element besnik, se jemi element me të cilin mund të punohet në mënyrë që të dëshmohet një lloj risie, në të cilin duhet të jetë Kosova shtet model i lirisë, i demokracisë, i dialogut dhe bashkëjetesës.

Martirizimi - forcë hyjnore - njerëzore

Nëse merret historia, unë atëherë do t'i kisha shkoqitur disa elemente që i konsideroj të rëndësishme, sidomos në këtë 2000-vjetor. E kemi lashtësinë dhe traditën. Pra, i kemi rrënjët, i kemi burimet. Pa histori nuk ka ardhmëri. Këtë lashtësi dhe këtë traditë në radhë të parë ne duhet ta njohim dhe ta ndriçojmë. Mirëpo, fatkeqësisht shumë shqiptarë nëse i pyet se çka ka qenë historia jonë 2000-vjeçare, si është zhvilluar ajo, pse ka ardhur prej një dukurie në një dukuri tjetër, shumëkush e ka humbur fijen. Thënë figurativisht, lëmshin e kemi, por fijen e kemi të humbur, mu për këtë edhe na ngjan që si të gjendemi në ballë të një pune, sillemi në stilin se, me mua ka filluar dhe me mua përfundon. Mu për këtë edhe e kemi këtë lëmsh të quajtur 2000-vjetor. Prandaj duhet ta gjejmë fijen që ta lidhim dhe ta rënditim historinë tonë, në mënyrë që të shohim se çka ka ndodhur me ne gjatë dy mileniumeve. Elementi tjetër është martirizimi si forcë hyjnore-njerëzore. Jemi ndër popujt e rrallë që gjatë këtyre 2000 vjetëve, më shumë se 13000 sish (vjet) i kemi kaluar nën sundimin e të tjerëve, pra, i kemi kaluar ndër martirizime. Kjo dëshmon një forcë të jashtëzakonshme hyjnore - njerëzore. Popujt të cilët kanë qenë shumë më të mëdhenjë se ne dhe kanë pasur rëndësi më të madhe, janë zhdukur edhe sot nuk dihet as ku kanë qenë, për ta dinë vetëm gërmadhat dhe analet histoike. Ndërkaq, ne i mbijetuam të gjitha, çka do të thotë se kemi gjallëruar. Kemi një forcë të brendshme e një fuqi, thënë fetarisht, kemi një provani të Zotit. Zoti jeton edhe me këtë popull. Këtë e argumentoj thjeshtë edhe me disa personalitete. Mbijetuam deri në shekullin XX, por edhe dhamë njerëz të mëdhenj si: Gjergj Kastriotin, Nënë Tereze, Atenagoren, Mikel Koliqin, Gjergj Fishtën, Ismail Kadaren, Ferid Muratin etj. Vlerësimet jo vetëm të shqiptarëve, por edhe ato botërore thonë se personalitetet e tilla janë të rralla dhe nuk vdesin kurrë. Dhe, është mrekulli që një popull i vogël dha personalitete kaq të mëdha. Nëse shkohet nga aspekti i së tashmes, atëherë mund ta bëjmë një analizë e cila duhet të na ndihmojë që ta gjejmë vetveten edhe në aspektin fetar si të gjithë krishterë. Jemi katolikë dhe ortodoksë, prandaj na nevojitet gjithnjë e më tepër dialogu ndërkishtar apo ndërkrishterë, të cilin e ka filluar në mënyrë të mrekullueshme Fan Stilian Noli me komisionin që ishte krijuar nga ana e Kishës katolike, e të cilin në dimensione botërore e lartësoi Atenagora. Ai u nis nga lëkura e vet e vuajtjeve dhe e pësimeve që i kishte populli dhe kisha e tij. Të afruar dhe të bashkuar mundemi dhe duhet të zhvillojmë dialogun ndër fetar. Këtu vijmë te kapitulli i mrekullueshëm yni, jovetëm i tolerencës fetare, por edhe i vëllazërisë së përbashkët, i traditës dhe i kulturës së përbashkët kombëtare dhe fetare me shumë shekuj. Prandaj, aftësia dhe mundësia, jo vetëm të durojmë njëri-tjetrin, ta gjejmë minimumin e modus vivendit, por të shkojmë shumë përpara, t'ia dëshmojmë vetvetes dhe botës se jemi të krishterë

dhe myslimanë dhe se nuk jemi në antagonizëm. Aq më tepër te ne që është dukuri, që është edhe unike në botën - krishterimi ynë është i islamizuar, sepse edhe ata që nuk u islamizuan për dy - tre shekuj, i kanë përvetësuar sjelljet islame. Sa për ilustrim ta analizojmë “Kanunin e Lekë Dukagjinit”. Ai nuk është kanun vetëm për katolikë e as vetëm për myslimanë, por është një kanun për shqiptarë. Apo, ta marrim botëkuptimin ndaj femrës apo ndaj jetës, është një botëkuptim i cili elemente dhe segmente orientale që na kanë ardhur përmes Turqisë dhe islamizimit. Në anën tjetër, kemi edhe një islamizëm të krishterizuar, sepse as pas dy - tre shekujsh nuk është arritur të shlyhen gjurmët dhe tiparet që janë karakteristikë krishtero - shqiptare. Prandaj, pikërisht nga ky këndvështrim jemi vëllezër si shqiptarë dhe dyfish si vëllezër dhe si fetarë, pra e kemi rastin e mrekullueshëm që të dëshmojmë se feja jo vetëm që nuk ndan dhe nuk përçan, por ofron, bashkon dhe krijon bashkësi, krijon ndjenjë të përbashkët për ne, si bijtë dhe bijat e Zotit.

Familja shqiptare - vatër e jetës

Poashtu, e kemi një rast të mrekullueshëm që para botës të dëshmojemi se ne tolerancën e kemi pasur dhe e kultivojmë me shekuj. Atëherë bota do ta shohë se në një botë të vogël, siç është ajo shqiptare, ndodhet diçka e madhe dhe e mrekullueshme edhe për botën.

Në rend të parë kemi një qytetërim dhe kulturë. Pra, shqiptari ka mbijetuar sepse ka qenë dashamiri dhe dhuruesi i jetës. Pasurinë më të e ka konsideruar jetën. Është flijuar dhe ka dhënë çdo gjë që edhe të tjerët të jetojnë. Mjerë ajo shtëpi që s'ka pleq dhe fëmijë. Shqiptari e pranon jetën në zanafillë si dhuratë të Zotit dhe si dhuratë të dashurisë prindërore. Shqiptari e respekton dhe e kultivon jetën deri në ofshamën e fundit, nuk e skajon plakun apo plakën, nuk e largon prej shtëpisë si barrë apo peshë, por i konsideron ata si një thesar, si një zinxhir që na lidhë me të kaluarën.

Prandaj, familja shqiptare ishte dhe duhet të jetë vatër e jetës. Ajo duhet të mbetet kopsht në të cilin lindet, jetohej e punohet bashkërisht. Lindja dhe vdekja të familjet shqiptare dhe populli shqiptar ndodhin në të njëjtën ditë. E kemi familjen dhe traditën tonë që e çmon, e nderon dhe e kultivon jetën. Mosrespektimi i kësaj është vetëvrasje. Shfarosjen nuk arritën të na bëjnë të tjerët. Por, nëse ne i përvetësojmë të këqijat e botës, si dështimin, shkurorezimin, jetën e pamoralshme të rinisë, drogën, prostitucionin, etj., atëherë, ata janë më të rrezikshme se ushtria dhe policia serbe. Nga këto s'mund të na mbrojnë as NATO-ja e askush tjetër. Nga këto ne duhet të mbrojmë vetvetën. Prandaj, është e rëndësishme që të vetëdijesohejmi dhe të përcaktohejmi edhe në këto kushte dhe rrethana, se çka do të bëjmë në mënyrë që vlerat e larta të mos i harrojmë. Ato, edhe më tepër duhet t'i kultivojmë, t'i fisnikërojmë, sepse kemi mbijetuar m'u për atë se ishim dashamirë dhe adhurues të jetës.

Elementi tjetër është bamirësia. Populli shqiptar dallohet si mik dhe dashamirë i të tjerëve.

Mikëpritja e popullit shqiptar tashmë ka hyrë pothuajse në legjendë, jo vetëm te ne, por edhe në botë. Bukë, kripë e zemër janë simbol që dëshmojnë se shqiptari e ka në shpirt të ndajë kafshatën. Shqiptari është altruist. Nuk jep vetëm të mirat materiale, por jep dhe dhuron vetvetën, që do të thotë se flijohet. Ndjenja e mikëpritjes, ndjenja e bamirësisë duhet të kultivohen edhe më shumë. Fundja, edhe gjatë këtyre dekadave që mbijetuam, sepse njerëzit nuk jetonin më vetëm për vete, apo për qejfe e lukse që mund t'i kishin disa, por jetuam që të mbijetojmë. E ndanim edhe kafshatën e mbramë dhe ishin të lumtur. Ne zbuluam se gjithmonë tjetri është vëlla dhe si vëlla. Tjetri ka të drejtë në të mirat që unë i kam. Nëse unë dyfish kam diçka, ajo nuk është imja.

Bamirësinë apo “Caritas-in” e ka edhe Amerika, Anglia, Italia, Franca, etj., por jo edhe bamirësinë tonë vëllazërore e gjithnjëzore.

Të jetojmë të frymëzuar dhe të motivuar

Të mos mendojmë se tashmë dolëm prej lufte dhe më nuk na duhet bamirësia. Bamirësia praktikisht është sofa dhe zemra e popullit. Aq sa dimë të flijohemi dhe të ndihmojmë të tjerët, aq i ndihmojmë vetvetës dhe kështu e mëshirojmë edhe Zotin të na ndihmojë ne. Të përpiqemi që të mos bijmë në rreziqet e një materializmi dhe konsumizmi, i cili i matë gjërat në prizmin e asaj që është kënaqësi - çka më pëlqen. Të shkojmë kah ajo se çka është e mirë, çka është e drejtë, çka është e vërtetë dhe çka na ndihmon të gjithëve që të ecim përpara. Pra, kultura dhe qytetërimi i jetës, dashurisë, bamirësisë dhe faljes, apo strategjia paqësore pa dhunë, të cilën ne e kemi kultivuar dhe dëshmuar. Në çdo mënyrë i kemi ikur luftës, sepse s’kemi besuar dhe nuk besojmë kurrë, se lufta dhe armët mund t’i zgjidhnin problemet ndërnjerëzore, ndërshtetërore apo ndërkombëtare. Kjo luftë na u imponua, prandaj pjesa më e madhe e popullit tonë i rroku armët dhe luftoi, sepse ajo ishte një vetëmbrojtje. Për këtë ishte një vetorganizim i vet popullit. Fundja, ishte çështje e një domosdoshmërie të imponuar nga kushtet dhe rrethanat tjera. Mirëpo, bota e kuptoi këtë dhe na përkrahu edhe ushtarakisht, por jo vetëm ushtarakisht.

Ardhmeria jonë është tash që të dimë të falim, t’i falim dhe edhe popujt tjerë, të mos bijmë në gracka e provokime që ta kthejmë të keqen me të keqe. Duhet ta kuptojmë se ne nuk jemi ndarësit e vetëm të drejtësisë.

Tash hakmarrja është vëllavrasje apo njerëzvrasje. Tashmë nuk mundemi vetëm ne ta kemi fatin tonë në dorë. Kush di të kërkojë falje dhe të falë, është në nivel të lartë, është në pedestalin e humanizmit. Edhe Papa ka thënë se shumë më i fortë është ai popull që di të falë popullin tjetër që ka shkaktuar plagë trupore e shpirtërore, materiale e morale. Pra, ne, nëse dëshirojmë ta kemi përkrahjen e Zotit dhe atë ndërkombëtare, duhet të falim dhe të kërkojmë falje, nëse diçka kemi gabuar. Vetëm Zoti është i pagabueshëm. Ta kultivojmë sa më shumë bamirësinë si rrugë dhe mundësi e afrimit dhe vëllazërimit tonë, sidomos ta ruajmë jetën si dhuratë më të madhe të Zotit. T’u ikim shëmtimeve dhe shkatërrimit të jetës. Jeta është një tërësi prej zanafillës e deri në vdekje, mu për këtë edhe duhet ta ketë dinjitetin e vet. Përpara se të dështojë jeta, dështon dashuria. Kjo bën që më parë të gjejë shprehje egoizmi dhe egocentrizmi. Nëse fillojmë të mendojmë në prizma të tillë, atëherë vështirë është që të krijojmë ardhmëri të lumtur. Duhet të jetojmë të frymëzuar dhe të motivuar, përfundoi dr. don Lush Gjergji.

E mira, ose e të gjithëve, ose e askujt

Po përjetojmë atë që e priten të parët tanë dhe ne - lirinë, që është mbarimi fatbardhë i dymileniumit të krishtërimit ndër ne. Në mileniumin e tretë, që sapo hapëruam, duhet të jemi aty ku e ka vendin populli ynë dhe kisha jonë, bashkë me popujt dhe kishat tjera krishtere - evropiane. Tash më shumë se kurrë duhet t’i përvjelim mëngët, t’ia ndërtojmë të mirën vetëvetës. E mira ose e të gjithëve, ose e askujt. Nëse sofa jonë është e varfër, atëherë nuk do të ketë as për ne, e as për miq. Ta begatojmë atë me punë, dashuri e afërsi në mes vete dhe me të gjithë. Vetëm nuk jetohet, përfundoi dr. don Lush Gjergji.

Frrok Kristaj “Kosova model për Mesdheun, Evropën dhe botën”, Rilindja, Prishtinë, 13 janar 2000, faqe 7

Në foto: Don Lushi me Imzot Mark Sopin duke dëshmuar për Kosovën në Washington

Dr. don LUSH GJERGJI

“NËNA TEREZE” - SOFËR E MBROJTJES SË DINJITETIT TË POPULLIT TONË

Për dhjetë vite sa egziston SHHB u ndihmuan rreth një million e 650 mijë banorë. SHHB hapi 92 ambulanca shëndetësore nëpër Kosovë dhe qendrën mjekësore “Nëna” në Prishtinë. Në qendër të vëmendjes tash i kemi dëshmorët dhe familjet e tyre

Sot, në Prishtinë mbahet Kuvendi i shoqatës humanitare-bëmirëse “Nëna Tereze” të Kosovës. Ndaj, për rezultatet e arritura gjatë dhjetë vjetëve, që kur në Kosovë funksionon kjo shoqatë e mirënjohur, shfrytëzuam rastin dhe zhvilluam një bisedë me dr. don Lush Gjergjin, kryetar i SHHB “Nëna Tereze” dhe veprimtar i gjithanshëm e famullitari i Kishës Shqiptare Katolike në Binçë të komunës së Vitisë.

Bamirësia

Kur e themeluan Shoqatën e kishim parasysh se varfëria të qon në derë që nuk duhet të shkosh, të kushtëzon që të kryesh vepra të ndyera, të bënë bashkëpunëtor të së keqës, të bënë çdo gjë tjetër pos vetvetës, që do të thotë se në momentin, kur njeriu nuk e ka të siguruar minimumin e ekzistencës, atëherë praktikisht mund të manipulohet në çfarëdo mënyre. Ndaj, ky ishte qëllimi ynë për ta themeluar Shoqatën vetëm e vetëm, që bëmirësia të zhvillohet në mesin tonë, në mesin e vëllezërve, në mënyrë, që të shpëtojmë dinjitetin e njeriut tonë, dinjitetin e famijes sonë dhe të mbarë popullit tonë. Kjo edhe bëri që t’i kthehemi vetvetës dhe të bëjmë diçka sidomos nga frymëzimi dhe vepra e Nënës Tereze, e cila si parim të parë e kishte, që të kërkohet dhe te ndihmohet i varfëri në mesin më të afërtë.

Andaj nëse shikoni me sytë e zemrës do të shihni se dikush afër jush ndoshta vuan në shpirt apo me trup. Shoqata në fillimi e pati nismëtarin e vet - don Zef Gashin, ish famullitar i Kishës së shën Ndout në Prishtinë, kurse tash arqipeshkv i Arqipeshkvisë së Tivarit, por pati edhe një grup nismëtarësh të tjerë vullnetmirë derisa erdhi deri te një profilizim i qëllimit të themelimit të shoqatës. Dëshira jonë ishte që parimet dhe frymëzimet e mëdha të Nënës Tereze, që ishin në nivelin botëror, të jetësohen edhe ndër ne, që edhe ne të krijojmë një rrjetë të solidaritetit për ta shpëtuar vetvetën, sepse siç thotë populli nëse dëshiron t’i ndihmohet vetvetës ndihmojë edhe të tjerët. Kjo bëri, që të caktojmë një këshill për ta konsultuar imzot Nikë Prelën, atëbotë ndihmës i ipeshkvit të Ipeshkvisë Shkup-Prizren, e i cili ndërroi jetë para katër vjetësh. Atij ia patëm paraqitur projektin për themelimin e shoqatës, kurse ai pas kësaj më luti mua si biograf i Nënës Tereze të pranojë detyrën e udhëheqësit të shoqatës nëpërmjet të procedurës së Kuvendit. Detyrën që ma ofroi imzot Nikë Prela mu duk e rëndë, mirëpo nuk pata fuqi shpirtërore ta

refuzojë sepse edhe ashtu atij asnjë herë në jetë nuk kam mundur t'i them jo. Kështu shoqata e mori rrugën e themelimit.

Megjithatë, më 1, 2 e 3 maj 1990, Imzot Nikë Prela, unë së bashku me don Dodë Gjergjin udhëtuam për Bukuresht, ku atë kohë gjendej në një vizitë Nëna Tereze. Shkuam për ta konsultuar edhe atë lidhur me themelimin e shoqatës, kurse ajo na u pat përgjegjur “Kallxojeni kujdesin për nevojtarë me dashuri në vepër”. Kjo përgjegje për ne ishte një lloj leje dhe frymëzim nga ajo për atë, që ne dëshironim të bëjmë këtu. Dhe, mu për këtë më 10 maj 1990, themeluam Shoqatën, që tash e dhjetë vjet funksionon me sukses të madh.

Parimet e shoqatës

SHHB “Nëna Tereze” e Kosovës i ka disa parime themelore. Ndër to është edhe ai, që të mos bazohemi në ndihmën e të tjerëve pa e sensibilizuar dhe pa e krijuar një rrjet të ndihmës reciproke në mes veti. Pastaj, nuk do të bazohemi në ndihmën materiale, por dëshirojmë që krushqit e bëmërisë së pari të kalojnë anë e kënd Kosovës për ta njohur gjendjen reale, për t'i regjistruar nevojtarët tanë, sepse atëherë ndihma do të arrijnë më së miri në duart e atyre, që vërtetë kanë nevojë për të. Së pari kemi filluar nga ajo që vëllau të ndihmon vëllaun, miku - mikun, sepse vetëm në këtë mënyrë do ta shpëtonim dinjitetin tonë dhe të njeriut tonë. Po ashtu, parim yni ishte dhe mbeti që shoqata të mos ketë karakter politik, kombëtar, fetar, qeveritar etj., në mënyrë që të mos kemi barriera të në ardhmën, por të ndihmojmë kudo që jeta është në rrezik aty të gjendemi ne, përkatësisht që të ndihmojmë të varfërit ndër më të varfër.

Zemra është ajo që i vënë në lëvizje organet e tjera të trupit të njeriut, andaj edhe ne filluam ashtu nga qendra kah terreni, që do të thotë kudo që gjenden të varfërit aty të gjendemi ne. Mu për këtë edhe pse deri në pranverën e vitit të kaluar kishim vështirësi të lëvizjes, ne duhej të shkonim atje ku kërkohej ndihma jonë, atje t'ua ofrojmë ndihmën e jo nevojtarët të vijnë te ne. Aktivistët tanë nëpër degë e nëndegë të shoqatës kudo nëpër Kosovë na mundësuan, që t'i gjejmë e t'i evidencojmë të varfërit në terren.

Me ta krijuam një afërsi, krijuam një mobilizim gjithëpopullor dhe populli e kuptoi se Nëna Tereze po i zgjatë duart e ndihmës kudo nëpër terren. Mu për këtë populli edhe sot thotë se po na ndihmon Nëna Tereze e jo shoqata e saj.

Në fakt, kjo bëri që populli të mos e ndijë vetën bonjak, sepse ai e ka Nënë Tereze që e ndihmon popullin kurdo dhe kudo.

Përveç kësaj edhe mërgata jonë ishte aktive në këtë drejtim. Edhe në mesin e tyre i themeluam **degët dhe nëndegët kështu që ishin krijuar** mekanizmat e grumbullimit të ndihmave, mirëpo më e rëndësishmja ishte se nëpërmes të mërgatës e arritëm edhe ndërkombëtarizimin e Kosovës për ta ndihmuar popullin e saj - Kosovën. Kjo na shtyri, që edhe ne të udhëtojmë jashtë për të paraqitur se çka dëshirojmë, çka na ka shtyrë për diçka të tillë dhe çka synojmë.

Mendoj se, pa shoqatën tonë do të ndodhte një tragjedi edhe më e madhe mbi popullin tonë, që e dëshironte okupatori serb. Mirëpo, shoqata bëri që të mos mbrohet vetëm kafshata apo petku, por në radhë të parë të mbrohej gjendja njerëzore e kombëtare e popullit tonë. Me sigurimin e ndihmave u realizua dhe u jetësua një kapitull i ri i frymëzimit të Nënës Tereze, sepse bëmë atë që ishte në frymën e saj dhe angazhimin e saj jetësor kudo nëpër botë, pra edhe te ne.

U ndihmuam gati një milion e 650 mijë banorë

Në vazhdim dr. don Lush Gjergji tha se në fillim kishin diku rreth 35 mijë varfnjakë, kurse më vonë arritëm deri te rrezikimi i tërësishëm i popullatës - deri në gati një milion e 650 mijë banorë të varfër (në gjysmën e parë të vitit 1999). Po ashtu i realizuam edhe nevojat specifike e jo vetëm ato të ushqimit e të veshmbathjes, kur popullatës i ofruan edhe kujdesin shëndetësor.

Krijua njësi të punës - e institucione alternative të shëndetësisë. Hapem 92 ambulanca shëndetësore nëpër Kosovë dhe qendrën mjekësore “Nëna” në Prishtinë. Në shërbimet mjekësore u angazhuan kuadrot më të afirmuara të mjekësisë së Kosovës. Të gjithë ata, sikurse edhe rreth 8000 aktivistë vullnetarë të tjerë punuan pa pagesë, përkatësisht punuan vullnetarisht në aktivitetet e shoqatës sonë. Ndonjë prej tyre u ndihmua me ushqime e veshmbathje si të gjithë varfnjakët tjerë. Po ashtu, të gjitha selitë (lokalet e degëve, të nëndegëve, depot apo lokalet e ambulancave etj.) na janë vënë në shërbim nga popullata jonë pa kurrëfarë kompenzimesh. Me këtë u krijuan kushte, që subjekti të mbaj objektin e jo anasjelltas. Kjo më ka shtyrë që t’u themë bashkëpunëtorëve, se ne i kemi ruajtur njerëzit, sepse njerëzit janë ata që do t’i ngrisin institucionet e asesesi institucionet-njerëzit. Kjo bëri që të kemi përkrahjen e mbarë popullatës sonë, përkrahje kjo që e befaso i botën për të mirë.

Megjithatë, tragjedia më e madhe në historinë e popullit tonë ndodhi në pranverën e vitit të kaluar (1999), ku pothuaj se tërë popullata jonë lëvizi nga trojet e veta.

Pjesa më e madhe u përzu nga Kosova, kurse pjesa tjetër u detyrua të jetojë nëpër male. Këtë e bëri pushtuesi serb, që ia kishte mësyer ta zbraste Kosovën nga shqiptarët dhe kështu përfundimisht të bëjë pastrimin etnik të Kosovës. Sido që ngjau aktivistët tanë dhe ndihma e SHHB “Nëna Tereze” depërtoi edhe nëpër male të Kosovës, por edhe nëpër kampe jashtë Kosovës. Aktivistët tanë sakrifikuam edhe jetën. Nga radhët e tyre - aktivistëve kemi edhe të vrarë, të plagosur, të zhdukur e të burgosur. Për ta ka reaguar edhe OKB-ja. Po ashtu, okupatorët serb na i kanë konfiskuar edhe ndihmat, barnat, depot...

Ndihma e bashkësisë ndërkombëtare

Ne na ka ndihmuar edhe bashkësia ndërkombëtare, si Mjekët pa kufi, të cilët na kanë dalë në ndihmë edhe atëherë kur fare pak dihej për Kosovën. Bile, atyre (mjekëve pa kufi) në fillim u ka prirë administratori i tashëm i Kosovës - dr. Bernard Kushner. Po ashtu, na kanë ndihmuar edhe asociacionet humanitare amerikane, si Mersicopsi, CRS-ja, pastaj Caritasi e shumë e shumë donarë e dashamirë të tjerë të popullit shqiptar të Kosovës.

Ndaj, sot me krenari mund të konstatojmë se gjatë këtyre dhjetë vjetëve u bë një punë e madhe dhe mjaft e dobishme. Me fjalë të tjera, tërë populli ishte në shërbim të shpërthimit kombëtar. Prandaj, tash kur jemi para Kuvendit të Shoqatës me kohë kemi bërë përgatitje edhe për një transformim, sidomos sipas kërkesave të faktorit ndërkombëtar, si UNMIK-ut. Në këto kushte e rrethana kërkohet një profesionalizëm edhe më i madh nga ne dhe qytetarët tanë. Tek e fundit në solidaritet nuk duhet të ketë rivalitet, sepse ka vend për të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë.

Gjithë ajo që është bërë është në rend të parë vepër e Provanisë së Zotit, e cila besnikërisht na ka përcjellur në këto periudha tejet të rrezikshme dhe të mjegulluara, populli ynë i mirë dhe bujar brenda dhe jashtë Kosovës, miqët tanë nga Evropa dhe Amerika, mbi të gjitha bashkëpunëtorët tanë.

Duke e përfunduar këtë bisedë, dr. don Lush Gjergji tha se tash jemi angazhuar edhe rreth dëshmorëve dhe familjeve të tyre, të cilët i humbën në luftë më të afërmit dhe më të dashurit. Po ashtu, jemi angazhuar edhe për të gjithë ata, që nga lufta por edhe pas luftës - nga minat, i kanë

humbur gjymtyrët e trupit, pastaj për të hendikepuarit, të zhdukurit, të burgosurit e kështu me radhë. Bile, tash shumë më tepër do t'i kushtojmë kujdes atyre që nga lufta mbetën të vetmuar, mbetën pa prindër apo prindërit pa fëmijë, gratë pa burra, e me fëmijë. Të tillët tash për tash jo vetëm që nuk kanë përkujdesje materiale, por nuk kanë edhe kontakte me njerëz, s'kanë shoqërim. Atyre do t'u dalim në ndihmë, përfundoi dr. don Lush Gjergji, kryetar i SHHB "Nënë Tereze" të Kosovës.

Frrok Kristaj "Nëna Tereze" - sofër e mbrojtjes së dinjitetit të popullit tonë", Rilindja, Prishtinë, 29 shkurt 2000, faqe 7

**Foto: Don Lushi me Imzot Dodë Gjergjin e Imzot Nikë në Bukuresht
Dr. don LUSH GJERGJI**

TA MËSOJMË ARTIN E DIALOGUT

Rinisë shqiptare i mungojnë modelet kulturore dhe shpirtërore të identifikimit dhe të identitetit. Dyfytërsia është pafytërsi. Të mos i fajsojmë të tjerët për ta shfajësuar vetën. Vetëm vëllazërisht dhe bashkërisht mund të zhvillohemi, të jetojmë dhe përparojmë, të jemi të sigurt dhe të lumtur. Pa falje e pajtim dhe pa drejtësi e dashuri s'ka paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme. Na nevojitet vetëdijësimi kombëtar e fetar se jemi vëllezër shqiptarë

Ditë më parë Iniciativa e Studentëve të Kosovës, në Prishtinë, mbajti ciklin e dytë të temave, që kësaj radhe iu kushtuan tolerancës ndërnjerëzore e ndëretnike në Kosovën e pasluftës. Për këtë temë të rëndësishme kësaj radhe ishte angazhuar të flasë dr. don Lush Gjergji, famullitar në Kishën Katolike Shqiptare të Binçes dhe humanist e veprimtar i dalluar shqiptar. Dr. don Lush Gjergji theksoi se ndër problemet kryesore të rinisë shqiptare sot është edhe mungesa e modeleve kulturore dhe shpirtërore për identifikim dhe identitet, virtyte këto që i kotribuojnë një edukimi më dinamik. Dikur i riu apo e reja kishte pothuajë një detyrë të vetme, mësimin dhe zbatimin sa më të përpikët të traditës të kulturës, të fesë, që të jetë si të tjerët, që t'iu permbahet rregullave tashmë të krjuara me shekuj.

Toleranca dhe mirëkuptimi - fryte të qytetërimit

Në vazhdim dr. don Lush Gjergji tha se ky ishte dhe deri diku edhe sot është mentaliteti ynë grumbullor, ku si pikë orientuese dhe përcaktuese është tradita, e kaluara, kontrollimi, sundimi, apo diktatura horizontale, **me parimin bazor si të tjerët, si të gjithë!** Botëkuptimi apo mendtaliteti grumbullor e robëron, nënshtron dhe e kushtëzon individin, njeriun si person, dhe atë e shkrin në grumbull, turmë njerëzish, duke ia mohuar të drejtën e të menduarit, lirinë e veprimit dhe të përcaktimit, mundësinë e ndryshimit dhe të përmirësimit.

Kush nuk u përmbahet normave apo ligjeve të këtilla dhe traditës, njolloset dhe kështu, moralisht dhe shpirtërisht asgjësohet. Mu për këtë shumëkush ose fare s'ka ndonjë mendim dhe përcaktim personal, ose s'ka guxim të jetë vetvetja, atë ta shprehë apo komunikoj para të tjerëve. Njerëzit e tillë nuk e kanë krijuar të menduarit, personalitetin bazor, por më shumë shkrihen në njerëz anonim, mundohen doemos t'i përshtaten rrethit, për t'u mbuluar me sjellje dhe qëndrime si të gjithë të tjerët. Këtu dhe kështu lind farizeizmi, formalizmi, sa për sy e faqe, përkatësisht dyfytërsia, që është pafytërsi, sepse kush i ka dy fytyra, në fakt, s'e ka asnjë.

Rreziku tjetër apo skajimi në drejtim të kundërt do t'ishte individualizmi i tepruar, ose "bajraktarizmi", ku çdokush do të sundojë mbi të tjerët me mënyra përjashtuese: vetem si të them unë! Në këtë këndvështrim të tjerët trajtohen si të paaftë, prandaj objektvizohen, vegëlsohen, nënçmohen dhe shtresohen në forma të ndryshme, si p. sh. Diktatura familjare, politike, shoqëror, kulturore, deri-diku edhe fetare, sidomos ndaj botës së femrore, ndaj të varfërve dhe të mjerëve, ndaj fëmijëve dhe ndaj rinisë. Këto dy skajime dëmtojnë dukshëm aftësitë e njeriut që të jetë vetvetja, mundësinë e bashkëpunimit, bashkëjetesës, dialogun, mbi të gjitha bashkësinë që thadrohet në dallime dhe përplotësime.

Hapi tjetër me rëndësi do të ishte njohja, pranimi dhe zhvillimi i vetvetes në të gjitha dimensionet, trup, psikë dhe shpirt, si dhe harmonizimi i elementeve të ndryshme për krijimin e vetëdijës tonë personale: kush jam, çka dua dhe si dua të realizohem. Vetëm njeriu i harmonizuar, me personalitet dhe identitet, me unin e vet mund të bëjë hapin vijues ndaj tjetrit - ti, duke njohur, pranuar dhe nderuar tjetrin si rast, mundësi, takim, bisedim, dialog, komunikim, shoqërim, begatim në marrëdhënie ndërpersonale.

Unë - ti - ne, janë tre hapat vendimtar për komunikim ndërnjëzësor. Ne i takojmë njëri-tjetrit, jemi jo njëri pranë tjetrit, si objekte, por më afër me dhe për njëri-tjetrin. Ne ende na mungon kultura e komunikimit ndërpersonale. Jemi ende në një nivel mjaft të ulët të zhvillimit të vetvetes si qenie personale, familjare dhe shoqërore, sepse me shekuj kemi pësuar dhe luftuar për të mbijetuar. Nuk e kemi mësuar artin e dialogut: jam vetvetja, je vetvetja dhe së bashku kërkojmë, gjejmë njëri-tjetrin. Vetëm vëllazërisht dhe bashkërisht mund të zhvillohemi, të jetojmë të përparojmë, të jemi të sigurt dhe të lumtur.

Liria s'është çka më pëlqen

Edukimi për liri dhe për përgjegjësi është edukim për vlera dhe për virtyte me botëkuptime dhe përcaktime të qarta jetësore, e jo për marri dhe për anarki. Liria s'është çka më pëlqen (hedonizmi), çka më duket mua (hamendja), çka më nevojitet (oportunizmi), çka bëjnë të tjerët (populizmi masiv), çka më ndihmon të pasurohem dhe të kam sukses (mallizëm dhe kariereizëm), por çka është e mirë e drejtë dhe e vërtetë. Ku nuk ka vlera ka pseudovlera, ku s'ka virtytet ka vese.

Edukimi për komunikim - edukim për takim, për afrim, për bashkim, për bisedë, për dialog, për kërkimin e të mirës së përbashkët, sepse ne jemi njerëz, lindim, jetojmë, zhvillohemi në marrëdhënie, dhe mu nga kjo varet kryesisht sukcesi, fati, lumturia, e tërë jeta. Shoqëria moderne më tepër mbështetet në atë çka kemi se sa në atë çka jemi, në materializëm, pasuri dhe varfëron dukshëm njeriun në marrëdhënie ndërpersonale.

Toleranca parimisht ka dy drejtime kryesore: etnike apo kombëtare dhe fetare. Toleranca është vlerë, bindje, virtyt, begatim, pasuri tekembramje edhe domosdoshmëri për të gjithë, pra, edhe për ne. Sot bota është pluraliste në çdo kuptim dhe drejtim, dhe me këtë shihet, matet, vlerësohet dhe vërtetohet aftësia e njeriut modern për bashkëpunim dhe bashkëjetesë, për krijimin e bashkimit në dallime. Mentaliteti ynë grumbullor shpeshherë përjashton çdokënd që nuk është si ne, i "vathës tonë" kombëtarisht, fetarisht, kulturalisht, politikisht, ekonomikisht, shoqërisht. Kështu ne dukshëm e varfërojmë vetveten, sepse nuk mësojmë dhe nuk marrim prej të tjerëve, por mbesim të ngurrar në vetvete, të mbyllur dhe të izoluar.

Toleranca ndëretnike duhet të na ndihmojë të vetëdijësohemi se nuk ka popull të keq, por ka udhëheqësi, politikë diktatoriale, e cila së pari e dëmton vetveten, popullin e vet, e pastaj edhe të tjerët. Ne, në asnjë mënyrë nuk guxojmë të identifikohe mi dhe përgjithësojmë popullin serb me

Milloseviqin, sepse kjo do të ishte një papjekuri dhe padrejtësi e madhe. Aq më pak guxojmë të jemi ndarësit e drejtësisë në nivelin personal, familjar apo shoqëror dhe kombëtar. Pa falje dhe pajtim, pa drejtësi dhe dashuri s'ka as paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme. Ky është një proces shumë i gjatë dhe mjaft i mundimshëm, por i domosdoshëm për të gjithë ne, sidomos për rininë tonë guximtare, e cila tashmë ka të drejtë dhe detyrë t'i krijojë parakushte lirisë dhe demokracisë reale.

Me dialogun ndërfaqetarak shqiptar mes të krishterëve dhe myslimanëve mund të ndikojmë pozitivisht në ruajtjen dhe kultivimin e vëllazërisë së përbashkët edhe kombëtare edhe fetare. Duhet të jemi të qartë edhe me vetveten edhe me të tjerët: ne si shqiptarë, fatkeqësisht, fetarisht jemi të ndarë, por fatbardhësisht jo edhe të përçarë. Kurrë tërësisht nuk e kemi humbur vetëdijen se jemi vëllezër, se kemi shumë më tepër gjëra që na bashkojnë se aso që na ndajnë. Tani na nevojitet vetëdijësimi edhe më i madh kombëtar, por edhe fetar, sepse jemi vëllezër si shqiptarë.

S'ka liri pa flakjen e së keqës

S'ka liri të plotë për njeriun, familjen e shoqërinë pa flakjen e të keqës, padrejtësisë, rrenave, mashtrimeve, dhunës. Armiku më i madh, diktatori më i rrezikshëm është dhuna, urrejtja, mënia, ndarja dhe përçarja në çfarëdo baza, sepse këto të zeza s'vdesin kurrë vetvetiu, por duhet flakur dhe luftuar vëllazërisht dhe bashkërisht.

S'ka dhunë të keqe serbe, dhe dhunë të mirë shqiptare

Deri sa të mos lirohemi prej dhunës, paaftësisë për bashkëjetesë dhe bashkëpunim më të mirë dhe në dobi të të gjithëve, s'jemi të lirë, mjerisht jetojmë vetëm për të bërë keq, e kjo mënyrë s'është e denjë për askë. Këtë duhet ta kuptojmë dhe ta pranojmë të gjithë, jo si kërkesë ndërkombëtare, edhe më pak për serbët, por për veten tonë, si i sëmuri, i cili nuk mjekohet për mjekun, por për vetveten, me ndihmën dhe bashkëpunimin e mjekut. Dhuna është e dëmshme gjithmonë dhe gjithëkund.

Egoizmi dhe egocentrizmi

Sot gati s'dijmë më ta dëgjojmë njëri-tjetrin, ngutemi, s'kemi mirëkuptim, sepse s'jemi të hapur, të sinqertë, por jemi maska, fajësojmë të tjerët për ta shfajësuar veten, jemi infantil, të papjekur dhe pa drejtëpeshim shpirtëror.

Në një klimë të tillë s'kemi bashkëbisedues, bashkëpunëtorë, bashkëshortësi. Nga këto forma lind egoizmi dhe egocentrizmi: punë për mua, jeta është imja, dhe bëj çka dua unë, përfundoi dr. don Lush Gjergji.

Frrok Kristaj "Ta mësojmë artin e dialogut", "Rilindja", Prishtinë, 27 janar 2001, faqe 18

Në Foto: Don Lushi në mesin e shumë të rinjve

Dr. don LUSH GJERGJI

KATEDRALJA NË PRISHTINËS NDRIÇON SHEKUJT

Kosova është derë në mes të Perëndimit dhe Lindjes. Rreth katedraleve përherë janë ngritur qendra të mëdha të kulturës. Katedralja nxjerr nga harresa, nëntoka, por edhe nga dhuna e urrejtja gjithë atë që na është rrënuar me shekuj. Ajo mundëson gjetjen e fijeve që na u këputën gjatë shekujve të përndjekjeve. Ne ende nuk kemi histori të mirfilltë kombëtare e aq më pak kemi histori fetare. Kisha Katolike Shqiptare ka dhënë shumë figura të ndritshme kombëtare e fetare. Katedralja do të ishte më tepër një piknisje se një pikarritje e studimeve të mirëfillta. Dashuria e Nënës Tereze ishte pasaporta e saj kudo nëper botë. Katedralja na paraqet para botës edhe si popull, por edhe si kishë (katolike)

Ideja për ngritjen e një katedraleje në Prishtinë, është e kahmotshme. Ajo sot është kërkesë mediate. Ndaj, për nevojën e ngritjes së Katedrales në kryeqendrën e Kosovës ditë më parë biseduam me meshtarin e njohur shqiptar, veprimtarin kombëtar, shkenctarin, psikologun, biografën më të njohur të Nënë Terezës, por edhe autorin e mbi 40 veprave të botuara e të përkthyer në 35 gjuhë të botës e të botuara në miliona ekzemplarë - dr. don Lush Gjergjin.

Katedralja - letërnjoftim i kosovës

Ç'do të thotë ngritja e një katedraleje në Prishtinë?

- Ndërtimi i Katedrales në kryeqendrën e Kosovës, në Prishtinë, ka një rëndësi të shumëfishtë dhe domethënie jo vetëm për aktualitetin tonë por ngritja e saj rrumbullakon 2000-vjetorin e krishterimit të popullit shqiptar dhe, në anën tjetër, hapë derë, hap orientim, horizont dhe perspektiv për ardhmëni, sepse në ngjarjet që kanë ndodhur dhe që po ndodhin në Kosovë, por edhe në viset e tjera etnike shqiptare, ne jemi derë në mes të Perëndimit dhe Lindjes. Si të tillë, jemi shumë të rëndësishëm, sepse nga këndvështrimi i asaj se nga dhe si do të zhvillohet Kosova në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar, por edhe në kontekstin më të gjërë të Mesdheut apo të Ballkanit, do të varet shumëçka në politikë, në kulturë, në shencë, art, në fe, në orientim e gjithëmbarshtëm të një bote, në të cilën do të arrijmë, dhashtë Zoti, shumë shpejt, në mënyrë që të jemi qytetar të fshatit Tokë, ku jemi aq pak, por shumë të ngacmuar e të coptuar në mes vete.

Në fakt, ç'është katedralja?

- Fjala katedrale vjen prej fjalës katedër. Katedra në rend të parë është seli. Seli ipeshkvore ka pasur pranë qendrave ku ka jetuar dhe punuar apostulli, që në fakt është ipeshkv. Ipeshkvët janë

zëvendësit e 12 apostujve. Kryeapostulli ishte shën Pjetri, kurse tash është Papa. Kishën katolike e udhëheq në mënyrë kolegjiale Papa si kryeapostull apo si zëvendës i parë i shën Pjetrit, kurse ipeshkvit tjerë janë zëvendësit (trashëgimtarët) e apostujve. Ata pranë **Rezidencës** e kanë pasur Kishën dhe në kishë e kanë pasur Selinë, e cila është quajtur katedra e ipeshkvit. Nga ajo në meshët kremtore, sidomos për Krishlindje dhe për Pashkë, por edhe në periudhat tjera liturgjike, ipeshkvi e ka pasur fjalën zyrtare dhe të mësimit sidomos për dy çështje: defide, që i përket fesë, dhe de virtute (de morale), që i përket moralit dhe vryteteve. Pra, ipeshkvi ishte dhe mbeti mësues i popullit në emër të Zotit dhe porosisë biblike të mishëruar në Jezu Krishtin.

Nga kjo del se rreth atyre katedrave, përkatësisht katedraleve janë ngritur qytete të mëdha dhe shumë të rëndësishme. Krejt historia e ngritjes së qyteteve, historia e artit, historia e kulturës, letërsia e shumëçka tjetër lidhe dhe ndërlidhet pikërisht me një pikë qendrore që ishte dhe është selia ipeshkvore. Ato qendra në radhë të parë kanë pasur edhe karakter të rëndësishëm politik, kulturor, shoqëror, por edhe karakter fetar. Prandaj, nëse nisemi nga kjo, ne dalëngadalë do t'i ringjallim katedrat tona, që i kemi pasur në Kosovë apo në Dardanië e dikurshme edhe më gjerësisht në Ilirikun e Shenjtë, që i ka përfshirë të gjitha ato vise e hapësira ku kanë jetuar paraardhësit tanë, ilirët, e ku sot jetojnë pasardhësit e ilirëve.

15-16 shekuj ishim të përndjekur

Çfarë shkaktoi dhuna mbi popullin tonë gjatë shekujve?

- Ne sot pot themi se po e luftojmë dhunën, por dhunën duhet ta luftojmë që nga zanafilla kur ajo aplikohet mbi popullin tonë, që nga koha romake, sllave, turke, prapë sllave, sllavo-komuniste e jo ta luftojmë vetëm këtë të fundit. Atë duhet ta çrrënjoshim nga këto troje dhe nga vetëdija jonë. Ndaj, si një pikë qendrore do ta quaja me këtë rast katedralen, që duhet të ngritet në kryeqendrën e Kosovës, sepse përmes saj **rekuperojmë** - nxjerrim nga harresa, nga nëntoka, nga dhuna dhe nga urrejtja gjithë atë që na ishte rrënuar gjatë shekujve. Rrënimet e përndjekjet na përcjellin qysh nga romakët, më vonë dyndjet e sllavëve, pastaj sundimi pesëshekullor turko-otoman e më vonë komunizmi, që buroi nga sllavët e ateizmi i njohur në ekstrem e që ka ekzistuar ne botë e aplikohet në Shqipëri, por edhe ndër ne për afro gjysmë shekulli. Nga kjo del se diku nga 20 shekujt e kaluar 15-16 shekuj ishin shekuj të përndjekjeve tona.

Pra, me një katedrale e me një katedër do ta kemi edhe ne mundësinë ku fjala e Zotit do të dëgjohej ex **chatedra**. Kur Papa ligjëron ex chatedra ai **ushtron** rolin e kryeipeshkvit, rolin e papës, apo të kryeipeshkvit **për mbarë Kishën Katolike**. Të njëjtën gjë e ka edhe ipeshkvi. Ipeshkvi po ashtu është ai i cili mbikëqyr jetën në rend të parë fetare, pra sa i përket fesë dhe moralit, por ka kujdesin e tij si prind, vëlla, mik apo dashamirës, që mundohet për të mirën e të gjithëve. Pra, një katedër e tillë do të ishte katedra e Zotit të dëshmuar, katedra e dashurisë, katedra e paqes, e pajtimit të njerëzve, katedra e dialogut si ndëretnik po ashtu edhe ndër fetar, katedra e cila do t'i gjente fijet tona që na u këputën gjatë shekujve, duke kërkuar dhe duke e gjetur vetveten dhe të vërtetën që të vijmë deri tek ajo, siç thoshte Gjeçovi ynë i madh, "lashtësia e lashtësisë", që është pikërisht krishterimi ynë me motivet bibliko-krishtere, të cilat na u dhuruan nga Zoti-Njeri - **Jezu Krishti**.

Nuk kemi histori të mirëfilitë kombëtare e as fetare

Përveç rolit fetar, edhe çka mund të bëjë katedralja?

- Ngritja e katedrales do ta kishte edhe një kuptim tjetër, kuptimin shkencor, juridik e administrative, që do të jepte shkas dhe mundësi të studiohet më mirë e kaluara jonë. Ne nuk

duhet të ndalemi vetëm në atë e po e ngrisim katedralen me të cilën dëshirojmë ta bëjmë një lloj rekapitulimi të asaj çka me shekuj okupatorët na e zhdukën, por ajo do të ishte edhe një shkak i një surprize të mirëfilltë. Më vjen keq që me këtë rast duhet të them me sinqeritetin më të madh vëllazëror se ne nuk kemi histori të mirëfilltë kombëtare e aq më pak kemi histori të mirëfillt fetare.

Çfarë i dha botës krishtërimi iliro-arbroro-shqiptar?

- Po, dimensionet e objekteve tjera rreth katedralës, asaj i japin karakter vendor, kultural, historik, shoqëror e fetar. Nga kjo del se **Kisha Katolike** prej zanafillës është munduar të merret me njeriun si të tillë dhe me gjithë problematikën që i takon njeriut dhe me preokupimet e tij. Kjo edhe është feja e Zotit të mishëruar, të dashurisë së mishëruar, sikur që do të thoshte Nëna Tereze “dashurisë në vepër”. Andaj, çdo çështje që është njerëzore i takon njerëzimit dhe fesë e **Kishës Katolike**. Në këtë drejtim nëse bëjmë një analizë retrosektive të 2000-vjetorit tonë, atëherë mund të konstatojmë fatbardhësisht se edhe kisha jonë me të gjitha cungimet, travajimet e sundimet që i pati gjatë shekujve, ajo ka dhënë figura të ndritshme, të cilat nuk janë vetëm figura krishtere e kishtarë apo kombëtare. Këtë mund ta ilustrojmë me figurën e shën Florit e shën Laurit të Ulpianës, martirë që i njuh bota, pastaj shën Niketë Dardanit, i cili ishte ipeshkv, mirëpo që bota e njuh si autor të himnit “Te Deum”, që konsiderohet si himni më i bukur i të gjitha kohëve e sidomos gjatë 2000 vjetëve që i lamë pas, pastaj shën Jeronimi, iliro-dalmat, i cili e bëri një shërbim të madh, pasi që fjalën e Zotit-Biblën (Vulgatën) e përktheu i pari në Evropë **në gjuhën latine që ishte gjuha popullore dhe e komunikimit** kështu me radhë.

Në shërbim të popullit dhe të Zotit

Në anën tjetër, vazhdimësia e katedraleve ilustruhet edhe me ipeshkvin Dakus të Dardanisë (ishte i pranishëm në Koncilin e Nices), me ipeshkvin iliro-dardan të Stobit të Dardanisë e kështu me radhë. **Mos të harrojmë se Kostantini i Madh me Ediktin e Milanos, në vitin 313, ia dha botës së atëhershme lirinë fetare, vepër kjo madhore për mbarë njerëzimin.** Me këtë rast do përmendur selia e lashtë ipeshkvore e shkupit të Dardanisë, pastaj selia ipeshkvore **në Prevalitana, Prizreni i sotshëm që nga viti 485**, ajo në Ulpianë, në Justinianë e sa e sa tjera, për të arritur deri në periudhën kur ishin të rrezikuar nga shkrirja e tërsishme, jo vetëm fetare, por edhe kombëtare nga sundimi turko-otoman. Pra, edhe klerikët kishtarë, në rend të parë arqipeshkvit, ipeshkvit, meshtarët, rregulltarët e rregulltares u vunë në shërbim të Zotit dhe të popullit. Këtu mund të përmenden figura të ndritshme të ipeshkëve që kanë lënë materiale të dorës së parë për studime shumëdimensionale të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë, si Pjetër Bogdani, Pjetër Mazreku, Gjon Nikoll Kazazi e deri te Shtjefën Gjeçovi e Gaspër **Gjini**. Çdo vizitë e ipeshkëve që i bënin terrenit ajo ishte vizitë institucionale (at limina apostularum) mbrenda kufijve apostulikë, sepse ata ishin të obliguar të raportojnë hollësisht për gjendjen e tërsishme të popullit të vet, ata ishin mbikëqyrës (fjala episkop vjen nga fjala **episkopeo**, që do të thotë mbikëqyrës). Pra, ipeshkvi është mbikëqyrës i gjendjes së tërsishme dhe prijës i popullit në mjedisin e caktuar. Nga ky kundërvështrim na mbetet t’i nxjerrim ngadalë figurat e ndritshme të ipeshkve tanë, për çka kontribut të madh ka dhënë i ndrituri dr. don Gaspër **Gjini** (nga Ferizaj), pastaj në këtë drejtim ka kontribuar edhe prof. dr. Zef Mirdita etj. Tash na nevojitet të hyjmë në studime të mirëfillta të institucioneve tona e jo vetëm të individëve. Këtë duhet ta bëjmë për t’i ndriçuar shekujt e të së kalurës dhe për t’i dhënë publicitet hapërim të krishterimit në këto troje, sepse më vonë pasojnë shekujt e përndjekjeve e të dyndjeve tona.

Ta gjejmë vetveten

Po, për këtë, ç' thotë arkeologjia shqiptare?

- Arkeologjia na kryen punë të mëdha. Nëpërmjet arkeologjisë ndiçohet lashtësia jonë, rrënjët tona, mbi të cilat ne duhët ta ndërtojmë rrugën e ardhmërisë. Pra, edhe nga ky aspekt katedralja do të ishte një pikënisje më tepër se një pikarritje e studimeve të mirëfillta, për të cilat duhet të krijohen institucione kishtarë, në mënyrë që ne si etni e lashtë, por edhe si realitet i sotëm ta njohim dhe ta gjejmë vetveten.

Kujt do të duhej t'i kushtoj katedralja e Kosovës në Prishtinë?

- Po. Katedralja e ardhshme në Prishtinë, ishte dashur t'i kushtoj martirëve tanë të të gjitha periudhave, sepse ajo që na ka përcjellë në histori pa dyshim se është martirizimi, prej atij më të hershmit, që fillon me shën Florin e shën Laurin e deri te martirët e ditëve tona. Ua kemi borgj t'ua kushtojmë edhe katedralen. Nëpërmjet katedralës do t'i kujtojmë ata. Mirëpo, katedralja do të mund t'i kushtoj edhe Nënë Terezës, e cila me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë i kaloi të gjitha kufijtë. Me këtë ajo u bë e vetmja qytetare e mbarë botës. Ajo vërtet kishte afro 20 pasaporta, mirëpo ngado që kaloi nuk kishte nevojë të tregoj asnjërin pasaportë, sepse atë kudo e njihnin dhe e çmonin për **Nënë**. Këto karakteristika do të duhej t'i ketë katedralja, në mënyrë që ajo të na paraqesë edhe si popull, por edhe si kishë. Përmes katedrales duhet ta ndriçojmë lashtësinë tonë, traditën dhe kulturën tonë. Sa për ilustrim, të përmendi edhe këtë: dy arkeolog slloven patën ardhur te unë në kohën e ngjarjeve të lavdishme të 81-ës. Ata më patën thënë se po të kishin mundësi dhe leje, tërë jetën do të kalonin këtu në Kosovë duke gjurmuar, sepse në Kosovë ka gjëra të mrekullueshme që flasin dhe e dëshmojnë lashtësinë, qytetërimin civilizimin dhe traditën me të cilin do të mahnitej bota, përkatësisht po të zbulohet kjo begati me siguri se botës do t'i shërbente si pikë orientuese. Mu për këtë them se mbrendia e kësaj toke ruan shumëçka, nëse jo për brezin tonë, për pasardhësit e popullit tonë po se po. Ajo lashtësi, që sot po kërkohet, dhe si orientim do të krijonte nga ne një fytyrë të re e të ndritshme për mileniumin, në të cilin veçsa kemi hapëruar.

Frrok Kristaj "Katedralja në Prishtinë ndriçon shekujt", "Rilindja", Prishtinë, 7 mars 2001, faqe 18

Në foto: Don Lushi së bashku presidentin e parë të Republikës së Kosovës, Dr. Ibrahim Rugovën, e me Imzot Mark Sopin duke e vënë gurthemelin e Katedrales "Nëna Tereze" në Prishtinë

Dr. don LUSH GJERGJI

ME TEMPULLIN E PAQES NË PRISHTINË, BOTA DO TË JETË NË KOSOVË PËR TË PUNUAR SI NË NJË FILIALË TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Ndër intelektualët më të spikatur të Kosovës, pa dyshim, është edhe dr. don Lush Gjergji, famullitar në Kishën e shën Ndout në Binçë të komunës të Vitisë. Në të vërtetë, dr. don Lush Gjergji është autor i 44 veprave në gjuhën shqipe, shumica prej të cilave janë të përkthyer në më se 35 gjuhë të botës. Njëherësh, ai është njohës i shtatë gjuhëve botërore. Ai është biografi më i njohur i Nënë Terezës dhe i çështjes shqiptare. Ditë më parë, dr. don Lush Gjergji u zgjodh anëtar i Akademisë evropiane, me seli në Bruksel

Ditë më parë jeni pranuar anëtar i Akademisë evropiane në Bruksel, si rodhi propozimi dhe për çfarë u pranuat?

- Akademia evropiane disa herë ka treguar interesim për veprat e mia, në veçanti për 13 botimet kushtuar Nënë Terezës, por edhe për veprimtarinë time, si hulumtimet shkencore, sidomos teza e disertacionit tim, si dhe për shumë artikuj studimor kushtuar familjes dhe shoqërisë. Unë gjithmonë kam punuar pa pasur ndonjë aspiratë ose pretendim për ndonjë titull, mirënjohje ose shpërblim, sepse detyra ime kryesore është ta shërbejë Zotin, ta shërbejë popullin, kishën dhe të mirën tonë të përbashkët.

Akademia evropiane dy herë radhazi ma ka kërkuar biografinë e unë nuk ju kam përgjigjur, kurse herën e tretë e kanë kuptuar se pse nuk iu kam përgjigjur. Në të vërtetë, në aplikacion pyetja e parë ishte se a jam anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërkaq personi që kishte ardhur nga Brukseli te unë për herë të tretë më tha që mos t'i përgjigjem pyetjes së parë. Dëshira ime ka qenë dhe mbetet që ne si intelektual, si njerëz të kulturës, të shkencës dhe të artit, të komunikojmë sa më tepër me botën. Kemi pasur një shkëputje më se 20-vjeçare, ndaj gjithë ajo që ka ndodhur dhe është krijuar ndër ne në Kosovë nga viti 1980-2000 praktikisht nuk ka pasur mundësi të depërtojë dhe të përkthehet në gjuhë të ndryshme të botës. Po e citoj vetëm rastin e veprës sime "Lule për Nënë", kur u përkthye në gjuhën italiane, atëherë kritika e ka vlerësuar lart poezinë, prozën, krijimtarinë figurative, muzikore etj., që i kushtohen Nënës Tereze. Madje, kritika thotë se poezi të tilla rrallë mund të gjenden në gjuhët e tjera. Kjo do të thotë se kemi krijuar dhe vlera të mirëfillta, të cilat kemi obligim t'i përkthejmë dhe t'ia paraqesim botës për të na njohur neve dhe vlerat tona. Pikërisht për këtë arsye nuk i kam dhënë rëndësi kandidimit tim për anëtar të Akademisë evropiane, por kam dashur që në një mënyrë të ndërmjetësor ku të jetë e mundur që kultura jonë në rend të parë të njihet nga ndërkombëtarët

dhe, në anën tjetër, të bëhen edhe shkëmbime të ndryshme institucionale që ne t'i marim vlerat evropiane e botërore e në anën tjetër ato t'i shkëmbejmë me vlerat tona.

Çka paraqet Nëna Terezë për shqiptarët?

- Nëna Terezë për popullin shqiptar paraqet sintezën, përmbledhjen e asaj çka është vlerë, draditë, kulturë, krishteim yni 2000-vjeçar, martirizim e shumëçka tjetër. Prandaj, do të thosha të gjitha të mirat që mund t'i ketë një popull janë përmbledhur në jetën dhe veprën e saj, sepse ajo më së miri e mishëroi atë se çka është kujdesi për të tjerët, bujarinë, mikpritjen, zemërgjerësinë dhe, mbi të gjitha, jetën kushtuar Zotit dhe njeriut ndër më të varfrit. Ajo dëshmoi fuqinë e fesë dhe të frymëzimit e dashurisë. Me Nënë Tereze kemi një përmbledhje të vlerave e të virtyteve gjithshqiptare, të cilat me Nënë Tereze u shëndërruan edhe në vlera gjithënjëzore e universale. Nëna Terezë për ne është simbol, është letërnjoftim, pasaportë, është metodologji dhe strategji për të dëshmuar se çka mund të bëjë njeriu që beson dhe dashuron dhe me çfarë fuqie ajo doli para të ligave të botës, si dhe se si pa askend arriti dalngadalë t'i përfitojë të gjithë, prej besimtarëve, Selinë e Shejntë, deri te shtetet e ndryshme, pra atje ku njerëzit nuk mund të shkonin as me mend - atje arriti Nëna Terezë. Me Nënë Tereze ndodhi mrekullia, që është flijimi në dashuri dhe për dashuri njerëzore **dhe kristiane.**

Bota shqiptare duhet të bëjë më shumë për Nënë Tereze. Duhet ta gjejë vetveten në Nënë Tereze, sepse ajo jo rastësisht qe shqiptare. Ajo është një përmbledhje e të gjitha të mirave tona, të traditës, kulturës dhe qytetërimit tonë. Nëna **Tereze** është e mrekullueshme dhe e madhe, por jo e shkëputur prej nesh. Do të ishte tragjedi sikur të lejonim shkëputjen e saj nga rrënjët tona, sepse edhe dom Valentino Salvoli, **teolog dhe shkrimtar i famshëm** nga Italia, thotë: “Kush dëshiron ta kuptojë popullin shqiptar dhe ta njohë atë, atë e bën duke e njohur Nënë Tereze, e njeh edhe popullin shqiptar”.

Po tempulli i paqes “Nëna Terezë”, që po ngritet në Kosovë, çka paraqet për ne?

- Tempulli i paqes pretendon të jetë një **“fabrikë”** ku do të punojnë vendasit dhe ndërkombëtarët, duke u nisur nga nobelistët e paqes, nga katedrat e paqes të universiteteve të ndryshme të botës, që të kemi një pikë orientuese, që të kemi një shtyllë, rreth së cilës mund të sillemi dhe të kërkojmë se çka ka ndodhur me ne dhe në mbarë botën, si dhe si të krijohet paqja. Me Nënë Tereze është definuar se çka është paqja dhe është arsyetuar çmimi Nobel për Paqe, që e mori më 10 dhjetor 1997, me ç'rast pati thënë: “Veprat e dashurisë janë vepra të paqes, dhe pa dashuri nuk do të ketë kurrë paqe”. Pra, paqja lind nga e vërteta, ndaj edhe njerëzit janë vëllezër e motra e që duhet të jetojnë në paqe. Me tempullin e paqes në Prishtinë, bota do të jetë në Kosovë për të punuar si në një filial të Kombeve të Bashkuara.

Sipas jush, kur filloj bashkimi i popullit shqiptar?

- Viti 1990 mendoj se është ndër vitet e rëndësishme në historinë tonë, sidomos pas humbjes edhe të asaj pak autonomie që e kishim. Praktikisht atëherë populli shqiptar mbeti pa kurrfar institucionesh. Ndaj, nuk kishte mbetur gjë tjetër përveç të vetorganizoheshim. Këtë e bëmë në mënyrë të fuqishme, duke e shprehur moralin dhe forcën tonë. Për t'i hyrë një afrie vetorganizuese, duhej të ballafaqoheshim në rend të parë me problemin e hakmarrjes, që si traditë ishte thadruar në shpirtin e shqiptarëve, ku mbizotëronte jo vetëm një traditë, por edhe një ligj i pashkruar se gjaku kurrë as nuk falet e as nuk humbet. Kjo konsiderohej si një detyrë e shenjtë, bile-bile te shumëkush edhe një lloj trimërie ose një lloj shqiptarie.

Ndërkaq, në vitin 1990 bashkë me të madhin profesor Anton Çettën dhe me rininë e studentët tanë filluam një veprimtari, që ishte që t'ua shpjegojmë njerëzve se ne të ndarë, të hasmuar, të armiqësuar mes vete dhe të përçarë nuk kemi gjasa të mbijetojmë e jo më të shkojmë përpara nga proceset demokratike, nga liria e pavarësia e plotë, sepse ishim praktikisht pre e vetvetes dhe e traditave tona, sepse duhej shpjeguar se nuk është traditë jona shqiptare dhe se nuk ka kurrfarë lidhje me atë se çka në fakt është historia, tradita e mirëfilltë shqiptare. Por, në një kohë historike e vetmja mënyrë për t'iu kundërvënë sundimtarëve, sidomos turko-otomanëve ishte favorizuar si prej turqve, po ashtu prej sundimtarëve të botës slave. Shqiptarët vriteshin dhe asgjesheshin mes vete. Ata nuk ishin në gjendje të kërkojnë diçka dhe të vetëformojnë shtetin, qenien ose identitetin kombëtar, fetar, kulturor, shpirtëror, por praktikisht ishin në procesin e vetërrënimit e vetëshkatërrimit. Prandaj, çdo vrasje dhe çdo hakmarrje nuk është gjë tjetër, përveçse vetëvrasje dhe vëllavrasje. Në të vërtetë, çdo vrasje është krim, kurse marrja e gjakut ose hakmarrja është krim i krimit, sepse bëhet me paramendim, përgatitje e organizim.

Me pajtimin e gjaqeve, ne e kemi krijuar një mrekulli të vërtetë. Njeriu që është në gjendje të falë një, dy e deri në katër gjaqe, dhe jo vetëm t'i falë, por edhe të krijoj miqësi dhe vllazëri me dorasin, kjo është vërtetë vepër e madhe e Zotit dhe vepër e madhe e popullit. Në këtë mënyrë jemi pajtuar dhe jemi bashkuar, për çka krijuam parakushte për procese të reja.

Me këto lëvizje - eleminimin e vëllavrasjes, bamirësinë, shëndetësinë dhe shkollën shqipe, krijuam sistemin paralel, që në fakt praktikisht krijuam një shtet, krijuam një pavarësi e një sistem të vetorganizimit, që dëshmoi para botës mbarë se jemi të aftë në çdo rrethanë të vetorganizohemi. Kjo edhe krijoi parakushte të strategjisë paqësore e jo dhunore, sepse në atë kohë nuk ishim në gjendje as të luftojmë, as të dorzohemi e as ta pranojmë robërinë. Pra, zgjodhëm strategjinë paqësore, e cila në botë bëri jehonë të madhe dhe ishte kjo ndër veprat e mëdha ku populli shprehu vetvetën se jemi të gatshëm të vdesim e të vetëflijohemi, vetëm e vetëm që të mos shkaktojmë vetëshkatërrim dhe vetasgjësim. Të gjitha këto krijuan parakushte në rend të parë që të formohet LDK-ja, si lëvizje gjithëpopullore, dhe pastaj të partive të tjera deri në vitin 1999, kur ndodhi pa dëshirën tonë edhe lufta e armatosur e popullit shqiptar kundër okupatorit serb, në krye me kryekriminelin Milosheviq. Atëherë bota e pa se një popull ndodhet para një shkatërrimi e asgjësimi. Për këtë edhe ndërhyri faktori ndërkombëtar. Këtu në rend të parë ndikoi faktori i informimit shqiptar që ishte në nivel të lartë në Kosovë. Nëpërmjet informimit bota na njohu si paqësorë, si bij dhe bija të Nënës Tereze, si njerëz që sakrifikohe mi për ruajtjen e identitetit tonë, si njerëz që flijohemi për të mbijetuar. Informimi ynë dhe, mbi të gjitha, ndihma e Zotit dhe përkrahja e ndërkombëtarëve bëri që populli ynë t'i shpëtojë rrezikut të madh ose zhdukjes e dëbimit, siç ndodhi në dy pranverat e shekullit të kaluar. **Këtu meritë të madhe pati pa dyshim dr. Ibrahim Rugova me bashkëpunëtorë, si lider i çmuar dhe i dalluar, vizionar, largpamës, strateg, njeri i cili na paraqiti denjësisht dhe pozitivisht para botës dhe krijoi miqësi me Amerikën, Evropën, Vatikanin, si dhe me mbarë botën e qytetëruar dhe demokratike.**

Çfarë mendoni për vitin e shenjtë shqiptar?

- Viti 2003 ishte vërtet vit i bekuar dhe i shenjtë për shqiptarët, i shpallur nga papa dhe Selia e Shenjtë, siq dihet, dhe vit i begatshëm për ne, sepse, siq dihet, është përkujtuar 300-vjetori i Kuvendit të Arbënit (1703), me çka u përkujtua se ku ishim para 300-vjetësh, kur ishte edhe papa shqiptar - Papë **Klementi XI**, apo siç është quajtur edhe Papë Albani, pastaj u përkujtua se çka ka bërë kisha katolike shqiptare për ruajtjen e identitetit shqiptar, të fesë, të gjuhës, traditës, historisë, kulturës shqiptare etj., praktikisht i të gjitha atyre që quheshin shqiptarizëm. Në të

vërtetë u analizua krejt çka ishte dhe kishte për të mësuar se historia është mësuesja e jetës. Në ato rrethana, Kuvendi i Arbënit paraqiste një rezistencë të fuqishme dhe një analizë të gjithmbarshme se kush ishim dhe kush jemi, e që kishte për qëllim mbrojtjen e identitetit për t'iu kthyer të vërtetës dhe vetvetes, për të mësuar nga historia për të djeshmën, të sotmen, sidomos për ardhmëninë, ai faktikisht nuk ka ardhmëni.

Po ku jemi sot ?

- Mendoj se jemi në rrugë të mirë, sepse pafajësia e popullit që ka pësuar me shekuj e edhe në kohën e afërt, ku ende e edhe sot nuk dihen varret e njerëzve të zhdukur, që shpeshherë janë të zhdukur edhe në mendje dhe zemrat tona e jo vetëm në varrezat masive dhe të panjohura. Pak kemi bërë ne e edhe ndërkombëtarët për fatin e të zhdukurve.

Tjetër, integrimi ynë shqiptar për t'i trajtuar çështjet tona vëllazërisht e bashkarisht dhe për të kërkuar rrugën sa më të shkurtër deri te caku përfundimtar i lirisë dhe i pavarësisë së plotë.

Mendoj se ndërkombëtarët bëjnë eksperimente me ne dhe dëshirojmë të na standardizojnë.

Megjithatë, unë nuk i shoh keq standardet që kërkohen, sepse këto standarde janë një lloj parakushti që të hyjmë në familjen e madhe evropiane, ku edhe e kemi vendin. Por pyes vetveten se çfarë standardesh duhet të plotësojmë ne si shqiptarë, a jemi të vetëdijesuar, të orientuar dhe të përcaktuar që vërtet të jemi të lirë në mënyrë të mirë që t'i dëshmojmë botës edhe njëherë se kemi merituar ndërhyrjen e tyre, përkrahjen dhe praninë e tyre, por meritojmë si gjithë popujt e tjerë të drejtën e vetëvendosjes.

Ndërkombëtarët në qarqet e larta, për aq sa vlerësoj unë, ende kanë nderin dhe admirimin për gjithë atë që ka ndodhur historikisht dhe aktualisht. Ata edhe i gëzohen çdo sukcesi tonë dhe dëshirojnë të na ndihmojnë. Ndërkaq, te shtresat e mesme dhe të ulëta ndërkombëtare ka filluar një lloj ftohjeje, sepse shpesh nga sjelljet tona ata hutohen edhe bëjnë pyetje se çka duan këta njerëz. Prandaj, çdo shqiptar, që nga ata të politikës, të shkencës, të kulturës dhe të artit, prej institucioneve më të larta që i kemi, që të gjithë duhen të mendojmë shumë herë para se të veprojmë. Njëherësh, duhet t'i gjejmë format për një bashkim vëllazëror, për një bashkëpunim më dinamik me bashkësinë ndërkombëtare, se vetëm me këta faktorë, por edhe me ndihmën e Zotit ne mund t'ia dalim që t'i realizojmë të gjitha synimet tona, që të jemi vetvetja, por pa ua mohuar të tjerëve që edhe ata të jenë vetvetja.

Frrok Kristaj - Rexhep Demiri: "Me tempullin e paqes në Prishtinë, bota do të jetë në Kosovë për të punuar si në një filialë të Kombeve të Bashkuara", Bota sot, Prishtinë, 9 dhjetor 2003, faqe 7

Në foto: Don Lushi duke e zbuluar shtatorën e Nënës Tereze në Prishtinë

Dr. don LUSH GJERGJI

PAPA GJON PALI II - DASHAMIR I SHQIPTARËVE

Karol Vojtila i ri, përkatësisht Papa Gjon Pali II ishte edhe artist, poet e dramaturg. Ai si papë hyri në sinagogë e në xhami dhe atje së bashku me predikuesit e besimeve përkatëse iu lut Zotit. Kosova për Papën Gjon Palin e Dytë ishte çështje e ndërjegjësjës njerëzore. Për shumëçka Papa e pat shpallur vitin 2003 vit të shenjtë për shqiptarët. Ky papë ishte ndër 25 personalitetet më të njohur të botës së shekullit XX

Ditë më parë në Vatikan kaloi në amshim Karol Vojtila, përkatësisht Ati i Shenjtë - Papa Gjon Pali II. Ai ishte ndër figurat më kryesore të botës së civilizuar. Megjithatë, ai ishte edhe mik dhe dashamir i popullit shqiptarë. Se ishte kështu për gazetën "Bota sot" bëme një intervistë me dr. don Lush Gjergjin, vikar i përgjithshëm i Ipeshkvisë së Kosovës, i cili edhe disa herë kishte pasur takime me Atin e Shenjtë, si dhe për te shumë herë edhe kishte shkruar.

I përndjekur nga nazistët

Kush ishte Karol Vojtila i hershëm, përkatësisht Papa Gjon Pali i Dytë i mëvonshëm?

- Jeta dhe vepra e Karol Vojtilës së hershëm, përkatësisht Papa Gjon Pali i Dytë i mëvonshëm, siç e vlerësoj unë, mund të ndahet në tri pjesë. Në rend të parë është jeta e tij fëmijërore dhe rinia, të cilën e ka pasur mjaft të vështirë, sepse në moshën 8-9-vjeçare i vdes nëna, në moshën 21-vjeçare i ati, pastaj e kishte një vëlla mjek për të cilin thuhet se ia kanë vrarë nazistat gjermanë, si dhe e kishte pasur një motër, që ishte shkolluar për motër nderi, por se para kushteve të përjetëshme i kishte vdekur në moshën 23-24-vjeçare. Nga kjo del se ai kishte mbetur i vetmuar. Megjithatë, ai aspironte të shoqërohej me mbarë botën.

Rininë e kishte pasur shumë të vështirë, sepse ishte edhe koha e tillë. Punoi në minierë. Ishte lexues i pasionuar. I interesonte posaçërisht historia, pastaj filozofia, por edhe drama e poezia. Në rininë e tij të hershme u takua me tekste të filozofisë kishtare, e sidomos me veprat e shën Augustinit, të cilat kanë pasur ndikim vendimtar në jetën e tij.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore që rrahur nga nazistat gjermanë deri në alivanosje, por fatbardhësisht atë e kishte gjetur në një përrua një grua e cila edhe e kishte mjekuar. Këto travajime ndikuan që Karol Vojtila vendosi të marrë rrugën e meshtarisë. Studimet i ka kryer në gjendje të vështirë, sepse në atë kohë Polonia ishte e okupuar nga gjermanët. Por, ai gati më tepër studioi në forma ilegale se sa të rregullt.

Thuhet se Karol Wojtila që në fillim të meshtarisë së tij ishte takuar me një figurë të kulturës shqiptare, për çka është fjala?

- Pasi që u bë meshtar shërbeu si kapelan e më vonë edhe si meshtar në afërsi të Krakovës dhe në vendlindjen e tij - në Vladovice, përkatësisht shërbeu në një kishë, e cila i kushtohej shën Florit. Sipas të gjitha gjasave bëhet fjalë për shën Florin tonë të Ulpianës së Dardanisë antike, i cili së bashku me shën Laurin ishin martirizua në mbrojtje të krishterimit. Karol Wojtila si meshtar i kishte kërkuar reliktet (eshtrat) e shën Florit nëpërmjet të kardinalit të atëhershëm të Polonisë dhe kishte arritur që pjesërisht t'i merrte reliktet nga Roma.

Për shkak të zellit të Karol Wojtilës arqipeshkvi i tij e dërgoi në studime pasdiplomike në Alfonziano të Romës, ku studioi dhe u doktorua në teologjinë morale. Më vonë, në moshën 35-36-vjeçare u emrua ipeshkv ndihmës e më pas u bë edhe titullar, pra arqipeshkëv i Krakovës dhe duke i parë aftësitë e tij intelektuale dhe organizative papa Pali VI e emroi edhe kardinal. Atëbotë kardinal me renome botërore ishte Vishinski. Karol Wojtila si i ri ishte dinamik. Ai kishte rënë në sy qysh në Konkilin e Dytë të Vatikanit, sidomos në punën e dy kushtetutave ("*Gëzimi dhe Shpresa*" dhe "*Drita e Popujve*"), që i dha Konkili i Vatikanit. Gjatë hartimit të këtyre dy dokumenteve ishte dëshmuar si njohës i shkëlqyshëm i gjendjes në Lindje dhe në Perëndim. Karol Wojtila në Krakovë ka pasur edhe vështirësi ashtu siç ka pasur edhe kisha nën sundimin e sistemit të egër komunisto-ateist.

Evropa ka dy realitete - kulturën perëndimore dhe atë lindore

Po si erdhi në shprehje Karol Wojtila për papë?

- Karol Wojtila në Romë ka ardhur si një befasi e jashtëzakonshme. Më kujtohet se Karol Wojtilen fare nuk ishte përmendur për papë. Përndryshe kardinajë të atëhershëm siç ishin Papalardo, me prejardhje arbëreshe nga Palermo, pastaj Siri nga Gjenova, Poleti nga Roma ishin përmendur, por kurrësesi Wojtila.

Do përmendur se konklava që e zgjedh papën nuk shkon sipas animeve e as sipas emrit të kardinajëve që kanë vendet e ndryshme, por ata zgjedhin njeriun më të përshtatshëm, më të aftë e sa më të mirë për kishën që e përfaqëson.

Megjithatë, Karol Wojtila ishte zgjedhur papë dhe e kishte marrë emrin Gjon Pali i Dytë. Ai kishte ardhur me mision të qartë. Mu për këtë po sa u paraqit tha se po vij prej së largu dhe nëse gaboj diçka në gjuhën italiane ju do të më përmirësoni. Ai kishte folur pa tekst të shkruar gjë që nuk ishte praktikë deri atëherë.

Dhe, unë që e njihja më herët, sepse një herë kisha qenë në shoqëri gjatë një darke, ai kishte një sinqeritet. Ishte i përtkushtuar Zojës së Bekuar, pra ishte papë marjan.

Opcionet e tij si papë ishin dy: për të shërbyer kishën katolike dhe për të ndihmuar jetësimin e koncilit të dytë të Vatikanit. Pra, ky ishte një papë i koncilit që kërkonte të jetësohej sidomos pika kryesore - riungjillizimi, që do të thotë se bota perëndimore për ndikim të ateizmit praktik të materializimit e shpesh herë shturjes morale ka humbur vitalitetin e fesë. Në anën tjetër, lindja ka pasur pengesa dhe kufizime ideologjike, sepse ka sunduar komunizmi zyrtar shtetërore-ateist. Andaj, sipas vlerësimit të papës si filozof dhe teolog i shquar thotë se edhe lindja e edhe perëndimi kanë nevojë për riungjillizim, që do të thotë se kanë nevojë të zbulojnë në Krishtin dhe në kishën katolike vlerat themelore njerëzore dhe të krishtera. Mu për këtë ai e kishte paraqitur vizionin e tij se nuk ekzistojnë dy Evropa - Perëndimore dhe Lindore, por se Evropa është një që ka dy mushkëri dhe frymon me të dyja. Për pos shën Benediktit, që ka qenë pajtor tradicional i Evropës, Papa Gjon Pali i Dytë shpalli edhe shën Qirilin e shën Metodin pajtor të

Evropës. Këtë e bëri për ta krijuar një afrim dhe bashkim të dy realiteteve që ekzistojnë në këtë kontinent. Dhe nuk u ndal vetëm në Evropën e Bashkuar, por ishte një papë që e vazhdoi traditën e papës Palit VI në udhëtimet pastorale (baritore) nëpër botë.

Gjatë pontifikatit të tij ai ka shkruar 14 enciklika dhe të pesëmbëdhjetën e la në përfundim e sipër, të cilat kanë të bëjnë mbi dashurinë e jetës, njeriut, familjes dhe të shoqërisë, pra mbi dashurinë që shndërrohet në bamirësi. Ky papë me vizionin e tij asnjëherë nuk e ndau kishën prej botës, sepse kishën e konsideronte pjesë të botës dhe nuk e ndau as botën prej kishës, sepse botën e konsideronte pjesë të kishës.

Papa Gjon Pali II u lut edhe në sinagogë e në xhami

Pse ky papë u njoh edhe si papë i primateve, i risive, rekordeve?

- Ati i Shenjtë - Papa Gjon Pali i Dytë u njoh edhe si papë i primateve, i risive, i rekordeve. Këtë e ilustron fakti se ky papë pas 2000 vjetëve të krishterimit shkoi në Sinagogën e hebrenjëve (1981) në Romë, ku takohet me rabinin me të cilin lexojnë motivet dhe psalmet e elementeve të **Besëlidhjes së Vjetër**, që janë të përbashkëta. Me atë rast papa ka kërkuar falje nga hebrenjtë për paragjykimet shekullore që në një farë mënyre e ngarkonin kishën katolike, e cila shpesh herë hebrenjtë i ka trajtuar si vrasarë të Krishtit. Me atë rast papa hebrenjtë i quajti vëllezër të mëdhenj apo të moçëm.

Po ashtu, ky papë pati takime pothuaj se me liderët e 12 feve të botës, me çka edhe filloi një lëvizje e madhe e paqes dhe e pajtimit të mbarë botës. Bile, ai (papa) theu edhe papagjykimet në mes të krishterimit dhe të islamizmit, sepse në vitin 2001 shkoi në një xhami për të nderuar traditën islamike. Aty u lut së bashku dhe me atë rast tha: "Bijtë e Abrahamit (tri fetë monoteiste) lypset kërkuar dhe gjetur Zotin si burim të paqes dhe si burim të pajtimit".

Çka paraqet për ne shqiptarët Papa Gjon Pali i Dytë?

- Ky papë - Gjon Pali i Dytë paraqet një kapitull krejtësisht të posaçëm. Ai e çmonte popullin tonë. Atë simpati kudo e ka shprehur.

Në vitin 1975, kur kisha vetëm dy vjet përvojë meshtarake, kam pasur rastin të jem në një darkë me Papa Gjon Palin e Dytë. Aty e kam parë se ai ishte i mrekullueshëm. Atë botë problem në vete paraqiste kisha në Shqipërinë ateiste. Më pat kapur për dore dhe më pat thënë: "Ti je i ri, por do të kesh rastin të shkosh në Shqipëri për të çuar meshë. Bile, ndoshta edhe unë do ta arrijë atë kohë". Po ashtu, në vizitën e parë që ia bëri imzoti tashmë i ndjerë Nikë Prela (1981) e me të cilin isha edhe unë, papa na pat thënë: "Unë pas popullit tima polakë më së shumti e dua popullin shqiptarë, sepse ju keni vuajtur gjatë, shumë dhe padrejtësisht. Por, mbi të gjitha popullin shqiptarë e dua, sepse ju e keni dhënë Nënë Tereze". Këtë simpati ai e kishte shprehur që kur ishte zgjedhur papë (16 tetor 1978), kur për Kërshëndella uroj festën në më se 40 gjuhë të botës, kurse ndër të parat e kishte rënditur gjuhën shqipe. Këtë e vazhdoi deri në fund të jetës së tij. Në anën tjetër, në vitin 1981 Ati i Shenjtë Papa Gjon Pali II e kishte vizituar Otrantën, pikën më të afërm të tokës së Italisë me Shqipërinë. Atje tërë predikimin e meshës ia kishte kushtuar Shqipërisë. Bile, në mes tjerash kishte thënë se "populli bujar i një shteti, që shihet edhe nga këtu, që ka një kulturë dhe një traditë të lashtë, i dëshirojë sa më parë të hapet nga vetvetja". Disa vite më vonë kishte shkuar në Bari të Italisë. Atje e kishte shpalosur dëshirën më të madhe duke thënë: "Popullin shqiptarë e kam gjithmonë në zemër. Ai e ka një kulturë të begatë dhe shumë të lashtë, me të cilën duhet të jetë krenarë. Ky popull ka një histori shumë të hershme, e sidomos të krishterimit që nga Durrësi e me shën Astin, shën Andreun, shën Palin e të tjerë, meriton ditë më

të mira". Ndërkaq, kur në Romë e pranoi një grup pelegrinësh shqiptarë pat thënë se "ky nuk është një takim i rëndomtë, sepse me ju jam çmallë, me ju që u takojë edhe mu si Krishti që është i gjallë këtu në Romë, është i gjallë edhe në atdheun tuaj, sepse askush nuk mund ta mbyt Zotin. Në fakt, kush mundohet ta mbyt Zotin e mbyt vetën, e mbytë familjen, mbytë njeriun e Zotit". Më vonë e pat pranuar edhe një grup tjetër, ku udhëheqte Atë Daniel Gjeçaj me të cilin ishte edhe don Rrok Mirdita, tash arqipeshkv i Tiranës e Durrësit, don Pjetër Popaj, nga SHBA-të e të tjerë. Edhe atyre u kishte bërë një rrëfim të vërtetë dhe shumë mallëngjyes e kështu me radhë. Megjithatë, më 25 prill 1993 Ati i Shenjtë e vizitoi Shqipërinë, që në fakt ishte shteti i parë në Gadishullin e Ilirisë që viziton ndonjëherë një papë. Atje mbajti katër fjalime, ku e përkrahu demokracinë e re që ndërtohej në Shqipëri. Atje po ashtu shuguroi katër ipeshkv dhe i riktheu strukturat e hierarkisë kishtarë, e sidomos një vit më vonë kur kishte emruar kardinal Mikel Koliqin.

Në anën tjetër, me fjalimin që e kishte mbajtur Papa Gjon Pali II në Tiranë e në Shkodër, ai i kishte bërë një kanonizim Nënë Terezes duke thënë se "këtu e kemi një person të vuajtur që është nga toka e juaj dhe tradita e juaj. Këtë e di gjithë bota. Dhe, derisa Shqipëria përmendet vetëm për zi dhe për të keq, kjo bijë e juaja dhe kjo motër jona, e ndriqoi traditën dhe kulturën e juaj dhe ju zbardhi fytyrën para botës mbarë. Në fakt, papa kishte dëshirë të madhe për ta kanonizuar Nënë Tereze dhe atë e bëri duke e lidhur me 25-vjetorin e pontifikatit të tij, ditën botërore të paqes dhe lumturimit të Nënë Terezes. Me atë rast ai pat thënë se dua që shqiptarët t'i kam në rendin e parë. Ashtu edhe ishte bërë. Po ashtu, më kujtohet kur ia pata dhuruar dy librat e mia, dy të parat "Nëna Tereze" dhe "Lule për Nënë", ia pata shkruar një përkushtim "Mikut të Nënë Tereze dhe mikut të popullit shqiptarë", kur e lexoi këtë falenderoi dhe tha "se vërtetë është ashtu. Më pat thënë se "ti na ke dhuruar Nënë Tereze edhe nëpërmjet të shkrimeve. Kështu edhe krijohet dhe tradita". Pastaj, botimet e këtilla m'i kërkoi edhe në gjuhën polake, të cilat edhe u botuan.

Ati i Shenjtë disa herë ka ndërhyrë edhe për çështjen e Kosovës

Meqenëse Papa Gjon Pali i Dytë është edhe krijues a kemi diçka të publikuar edhe në gjuhën tonë shqipe?

- Papa Gjon Pali i Dytë shumë herë ka ndërhyrë edhe për çështjen e Kosovës. Këtë e dëshmon edhe vepra "Selia e Shenjtë dhe kriza në Kosovë, pastaj në gjuhën shqipe janë edhe dy vepra e karol Vojtiles "Bregu i qetësisë", poezi të përkthyer nga Mazllum Saneja dhe "Të kapërcehet pragu i shpresës" në përkthim të Gjon Shllakut dhe e botuar nga Gjekë Gjolekaj në Nju Jork, si dhe don David Gjugaj ka botuar monografinë "Papa në Shqipëri", Drita - Radio-Vatikani. Krejt këto bënë që me angazhimin e Nënë Terezes nëpërmjet Papës, SHBA-të dhe Evropa ndërhyri në rastin e luftës në Kosovë. Këtë e dëshmoi edhe administratori i dytë, Bernard Kushner, pat thënë: "Unë e kam takuar shumë herë Nënë Terezen, si përfaqësues i OKB-së dhe i "Mjekëve pa kufi". Gjithmonë më ka thënë "ju duhet të bëni çdo gjë për popullin tim shqiptarë, sidomos për Kosovës. Nuk di sa e dini se në Kosovë ndodhin gjëra të tmerrshme. Unë i pata thënë se ne veç jemi atje të pranishëm". Edhe vet Kofi Anan e ka vërtetuar këtë duke thënë se "Papa më pat fol shumë lidhur me rastin e Kosovës". Pra, Nëna Tereze dhe Ati i Shenjtë ishin dy hallkat nëpërmjet të cilëve u angazhua mbarë bota, pa të cilët ndoshta bota as që do të dinte se kush jemi ne".

Fundja, **Papa** pat thënë se "çka doni më tepër nga unë kur ju jeni model për Evropën dhe botën për ekumenizëm, dialog ndërfaqetarak, dialog ndërreligjioz, tolerancën ndërreligjioze, sepse tradita e juaj, gjithmonë këto i ka".

Në vitin 1981 gjatë një audience të së mërkurës pat thënë se "nga një shtet fqinj po na vijnë informata trishtuese". Atje po ndodhin ngjarje të përgjakshme. Një popull i lashtë po pëson në vendin e vet. Mendoni se si kur bota përgatitet për festën e ringjalljes - Pashkët, ata vriten dhe u shkojnë nënave në arkivole. Atje ngjan mu si i ngjau Zojës së Bekuar kur iu mundua Jezu Krishti dhe iu gozhduar në kryq.

Nga ajo kohë e deri më tash Papa i kishte urdhërua Sekretarisë së Vatikanit që çfardo delegacioni që vie nga Kosova mund të hyjë pa probleme te ai (papa). Takim me papën ka pasur diaspora herë dr. Ibrahim Rugova, kryetari i Kosovës, por edhe intelektual e liderë të tjerë. Bile, nga Sekretaria u patem njohtua se meqenëse Kosova nuk ka ambasada diplomatike mund t'i shfrytëzojmë nunciaturat (ambasadat) e Vatikanit nëpër botë për të plasuar të vërtetën. Këtë edhe e kemi bërë në shumë raste. Njëherësh për ngjarjet në Kosovë nuk do të dinte askush në botë sikur të mos ishte Nëna Tereze, e cila nëpërmjet Papës e sensibilizonte opinionin.

Pak shënime për Papa Gjon Palin II

Karol Wojtila, përkatësisht Ati i Shenjtë Papa Gjon Pali i Dytë ishte personi më i njohur në botë. Ai i ka folur tetë gjuhë. Është zgjedhur papë në moshën 58-vjeçare, që në fakt ishte papa më i ri i zgjedhur në shekullin e kaluar. Ishte papa i parë jo italian pas 455 vjetëve të fundit. Papa Gjon Pali i Dytë ka vizituar më se 130 shtete të botës (përfshirë këtu edhe Shqipërinë), që përafërsisht 27 herë është sjellur rreth botës.

Vlen të përmendet se ky papë gjatë jetës së tij ka çuar mbi 19 mijë meshë, ku vetëm në atë që e ka çuar në Manillë kanë marrë pjesë afro katër milionë e gjysëm besimtarë. Ky Atë i Shenjtë ka shpallur të shenjtë afro 400 shenjtër, që është më shumë se të gjithë papët tjerë bashkë.

Në moshën 61-vjeçare i ka shpëtuar një atentati nga i cili ka marrë plagë serioze. Më pasë ai atentatorin e ka vizituar në burg dhe ia ka falur mëkatin.

Nëna Tereze - Krishti dhe kisha e të krishterëve

Në të kthyer nga një vizitë në Indi një gazetar italian e pyet Papa Gjon Palin e Dytë se si keni mund të përballoni këtë mundim të madh, kurse ai ishte përgjegjës: "Jo kjo ishte vizita më e lehtë imja, sepse më mjaftonte të bëjë me gisht e të tregoj se kush është Krishti, kush është i krishteri dhe kush është kisha e të krishterit, tregojta kah Nëna Tereze. Ajo ma lehtësonte mundin".

Bill Klintoni te varri i Nënës Tereze

Pas kalimit të mandatit të Bill Klintonit si kryetar i SHBA-ve, ai (Klinton) kishte shkuar me familje për ta vizituar varrin e Nënës Terezës. Për 25 minuta ai nuk kishte lejuar që të jetë askush me te, pra as bashkëshortja e as vajza e tij. Ashtu vetëm kishte qëndruar pranë varrit dhe me atë rast në meditim e kishte zhvilluar një dialog me Nënë Tereze. Kur doli i përplotur tha: "Ky ishte një takim i përmallshëm me Nënë Tereze. Unë i thash asaj se amanetin tëndë që e kam pasur për borgj ta kryej e kam realizuar, kurse tash duhet të kërkoj që ti ta kryesh një borgj ndaj meje, familjes sime dhe Amerikës". Pra çështja e Kosovës ishte çështje e ndërgjegjës njerëzore.

Viti 2003 ishte vit i shenjtë i shqiptarëve

Vitin 2003 Papa Gjon Pali i Dytë e kishte shpallur vit të shenjtë të shqiptarëve. Kishte vepruar kështu pasi që dëshiroi të nderojë shqiptarët, përkatësisht të nderoj papën e fundit shqiptar - Gjon Françesk Albanin - Papë Klimentin XI, pastaj nderoi 300-vjetorin e Kuvendit të Arbënit, por nderoi edhe mundimet e shqiptarëve që i paten në ndërrim të shekujve si në Kosovë, Shqipëri, Kosovën Lindore, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Andaj edhe e mori vitin 2003 si vit të shenjtë **për ne**, përkatësisht si përfundim të të këqijave mbi shqiptarët. Kjo më së miri flet se shqiptarët ishin të privilegjuar në zemrën e madhe të Atit të Shenjtë - Papa Gjon Palit të Dytë.

Papa Gjon Pali II ndër 25 personalitetet e shekullit

Në librin "Dashuria që nuk vdes" të dr. don Lush Gjergjit ndër 25 personalitetet më të njohur të shekullit ishte renditur edhe Ati i Shenjtë - Papa Gjon Pali i Dytë. Dhe, kur ky libër i ishte dorëzuar nga autori Papës, ai ishte falenderua. Libri është i botuar në gjuhë të ndryshme të botës. *Frrok Kristaj "Papa Gjon Pali II - dashmir i shqiptarëve", Bota sot, Prishtinë, 9 prill 2005, faqe 6 e 7*

Në foto: Don Lushi me Imzot Nikë Prelen duke ia dorëzuar një punim artistik Papës

Dr. don LUSH GJERGJI

AMBASADOR I KULTURËS SHQIPTARE

Dr. don Lush Gjergji është aurtor i 60 veprave, shumica prej të cilave janë të përkthyer në më se 35 gjuhë botërore. Ai është biografi më i njohur në botë i Nënës Tereze. Ta gjejmë vetvehten në Nënë Tereze. Veprat e dashurisë janë vepra të paqës. Në mbrojtje të identitetin u flijuam për të mbijetuar. Kush nuk ka histori, nuk ka as ardhmëri. A po na zhduken të zhdukurit edhe nga mendja e zemra(?!). Standardet - parakushte për të hyrë në familjen e madhe evropiane

Ndër intelektualët më të spikatur të Kosovës, pa dyshium se është edhe dr. don Lush Gjergji, famullitar në Kishën e shën Ndout në Binçë të komunës të Vitisë. Në fakt, dr. don Lush Gjergji është autor i 44 veprave në gjuhën shqipe, shumica prej të cilave janë të përkthyer mbi 35 gjuhë të botës. Njëherësh, ai është njohës i shtatë gjuhëve botërore. Ai është biografi më i njohur i Nënë Terezës dhe çështjes shqiptare. Ditë më parë dr. don Lush Gjergji u zgjodh anëtar i Akademisë evropiane me seli në Bruksel. Për këtë shfrytëzuar rastin dhe bëmë intervistë për lexuesit e kombëtares "Bota sot".

Të përkthejmë dhe të përkthehemi

Ditë më parë jeni pranuar anëtar i Akademisë evropiane në Bruksel, si rrjedhi propozimi dhe për çfarë u pranuat?

- Akademia evropiane disa herë ka treguar interesim për veprat e mia, e në veçanti 13 botimet kushtuar Nënë Terezës, por edhe për veprimtarinë time, si hulumtimet shkenore sidomos teza e disertacionit tim, si dhe për shumë artikuj studimor kushtuar familjes dhe shoqërisë. Unë gjithmonë kam punuar pa pasur ndonjë aspirat apo pretendim për ndonjë titull, mirënjohje apo shpërblim, sepse detyra ime kryesore është të shërbejë Zotin, të shërbejë popullin, kishën dhe të mirën tonë të përbashkët. Akademia evropiane dy herë radhazi më ka kërkuar biografinë e unë nuk iu kam përgjigjur, kurse herën e tretë e kanë kuptuar se pse nuk iu kam përgjigjur. Në fakt në aplikacion pytja e parë ishte se a jam anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërkaq personi që kishte ardhur nga Brukseli te unë për herë të tretë më tha që të mos përgjigjem në pytjen e parë. Dëshira ime ka qenë dhe mbetet që ne si intelektual, si njerëz të

kulturës, të shkencës dhe të artit, të komunikojmë sa më tepër me botën. Kemi pasur një shkëputje më se 20-vjeçare, ndaj gjithë ajo që ka ndodhur dhe është krijuar ndër ne në Kosovë nga viti 1980-2000 praktikisht nuk ka pasur mundësi të depërtojë dhe të përkthehet në gjuhë të ndryshme të botës. Po e citojë vetëm rastin e veprës sime “Lule për Nënë” kur u përktheje në gjuhën italiane, atëherë kritika e ka vlerësuar lart poezinë, prozën, krijimtarinë figurative, muzikore etj, që i kushtohen Nënë Terezës, e sidomos është vlerësuar lartë poezia shqipe që i kushtohet Nënë Terezës. Bile, kritika thotë se poezi të tilla rrallë mund të gjinden në gjuhët tjera. Kjo do të thotë se kemi krijuar dhe vlera të mirëfillta, të cilat kemi obligim t’i përkthejmë dhe t’ia paraqesim botës për të na njohtë ne dhe vlerat tona. Pikërisht për këtë arsye nuk i kam dhënë rëndësi kandidimit tim për anëtar të Akademisë evropiane, por kam dashur që në një mënyrë të ndërmjetësorë ku të jetë e mundshme që kultura jonë në rend të parë të njihet nga ndërkombëtarët, dhe në anën tjetër, të bëhen edhe shkëmbime të ndryshme institucionale që ne t’i marrim vlerat evropiane e botërore e në anën tjetër ato t’i shkëmbejmë me vlerat tona.

Gjuha e përbashkët është dashuri

Çka paraqet Nëna Tereze për shqiptarët?

- Nëna Tereze për popullin shqiptar paraqet sintezën, përmbledhjen e asaj çka është vlerë, traditë, kulturë, krishterim ynë 2000-vjeçar, martirizim e shumëçka tjetër. Prandaj, do të thosha të gjitha të mirat që mund t’i ketë një popull janë përmbledhur në jetën dhe veprën e saj, sepse ajo më së miri e mishëroj atë se çka është kujdesi për të tjerët, bujarinë, mikpritjen, zemërgjërësinë e mbi të gjitha jetën kushtuar Zotit dhe njeriut ndër më të varfërit. Ajo dëshmoi fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë. Me Nënë Terezën kemi një përmbledhje të vlerave e të virtyteve gjithshqiptare, të cilat me Nënë Terezën u shëndërruan edhe në vlera gjithnjëzore e universale. Nëna Tereze për ne është simbol, është letërnjohtim, pasaport, është metodologji dhe strategji për të dëshmuar se çka mund të bëjë njeriu që beson dhe dashuron dhe me çfarë fuqie ajo doli para të ligave të botës, si dhe se si pa askend arriti dalëngadalë t’i përfitojë të gjithë, prej besimtarëve, Selisë së Shenjtë, deri te shtetet e ndryshme, pra atje ku njerëzit nuk mund të shkonin as me mend - atje arriti Nëna Tereze. Me Nënë Terezën ndodhi mrekullia, që është flijimi në dashuri dhe për dashuri njerëzore.

Bota shqiptare duhet të bëjë më shumë për Nënë Terezën. Duhet ta gjejë vetvehten në Nënë Terezën, sepse ajo jo rastësisht qe shqiptare. Ajo është një përmbledhje e të gjitha të mirave tona, të traditës, kulturës dhe qytetërimit tonë. Nëna Tereze është e mrekullueshme dhe e madhe, por jo e shkëputur prej nesh. Do të ishte tragjedi sikur të lejonim shkëputjen e saj nga rrënjët tona, sepse edhe don Valentino Salvoli, nga Italia, thotë “kush dëshiron ta kuptojë popullin shqiptarë dhe ta njoh atë, atë e bënë duke e njohur Nënë Terezën, dhe kush e njeh Nënë Terezën e njeh edhe popullin shqiptar”.

Po, për botën?

- Ndërkaq, për botën Nëna Tereze është për ta kuptuar fenomenin e mirësisë dhe të dashurisë. Ajo është çelës për t’i kuptuar rrënjët, gjurmët, burimin dhe historinë tonë kombëtare dhe kishtarë. Bota me Nënë Terezën na pranon. Bota i pranon vlerat e mirëfillta që ajo ia dhuroi mbarënjëzimit.

Po Tempulli i Paqes “Nëna Terezë”, që po ngritet në Kosovë, çka paraqet për ne?

- Tempulli i Paqes pretendon të jetë një fabrikë ku do të punojnë vendasit dhe ndërkombëtarët, duke u nisur nga nobelistët e paqes, nga katedrat e paqes të universiteteve të ndryshme të botës, që të kemi një pikë orientuese, që të kemi një shtyllë rreth të cilit mund të sillemi dhe të kërkojmë se çka ka ndodhur me ne dhe në mbarë botën, si dhe si të krijohet paqja. Me Nënë Terezën është definuar se çka është paqja dhe është arsyetuar Çmimi Nobel për Paqë, që e mori me 10 dhjetor 1997, me ç'rast pat thënë: "Veprat e dashurisë janë vepra të paqes, dhe pa dashuri nuk do të ketë kurrë paqe". Pra, paqja lind nga e vërteta ndaj edhe njerësit janë vëllezër dhe motra e që duhet të jetojnë në paqë. Me Tempullin e Paqes në Prishtinë bota do të jetë në Kosovë për të punuar si në një filial të Kombeve të Bashkuara.

Zhdukja e vëllavrasjeve bashkoi popullin

Sipas jush kur filloi bashkimi i popullit shqiptar?

- Viti 1990 mendoj se është ndër vitet e rëndësishme në historinë tonë, sidomos pas humbjes edhe të asaj pak autonomie që e kishim. Praktikisht atëherë populli shqiptar mbeti pa kurrfarë institucionesh. Ndaj, nuk kishte mbetur gjë tjetër veç që të vetorganizoheshim. Këtë e bëmë në mënyrë të fuqishme duke e shprehur moralin dhe forcën tonë. Për t'i hyrë një afrie vetorganizuese, duhej të ballafaqoheshim në rend të parë me problemin e hakmarrjes, e cila si traditë ishte thadruar në shpirtin e shqiptarëve ku mbizotëronte jo vetëm një traditë por edhe një ligj i pashkruar se gjaku kurrë as nuk falet e as nuk humbet. Kjo konsiderohej si një detyrë e shenjtë, bile-bile te shumëkush edhe një lloj trimërie apo një lloj shqiptarie. Ndërsa në vitin 1990 bashkë me të madhin profesor Anton Çettën dhe me rininë e studentë tanë filluam një veprimtari, e cila ishte që t'ua shpjegojmë njerëzve se ne të ndarë, të hasmuar, të armiqësuar mes veti dhe të përçarë nuk kemi gjasa të mbijetojmë e jo më të shkojmë përpara kah proceset demokratike, kah liria e pavarësia e plotë, sepse ishim praktikisht pre e vetvetes dhe e traditave tona, sepse duhej shpjeguar se nuk është traditë e jona shqiptare dhe se nuk ka kurrfarë lidhje me atë se çka në fakt është historia, tradita e mirëfillt shqiptare. Por në një kohë historike e vetmja mënyrë për t'iu kundërvënë sundimtarëve, sidomos turko-otomanëve ishte favorizura vëllavrasja në mes të shqiptarëve si prej turqve e po ashtu prej sundimtarëve të botës sllave. Shqiptarët vriteshin dhe asgjësoheshin në mes veti. Ata nuk ishin në gjendje të kërkojnë diçka dhe të vetëformojnë shtetin, qenien apo identitetin kombëtar, fetar, kulturor, shpirtëror, por praktikisht ishin në procesin e vetrrënimit e vetshkatërrimit. Prandaj, çdo vrasje dhe çdo hakmarrje nuk është gjë tjetër përveç se vetvrasje dhe vëllavrasje. Në fakt, çdo vrasje është krim, kurse marrja e gjakut apo hakmarrja është krim i krimit, sepse bëhet me paramendim, përgatitje e organizim.

Me pajtimin e gjaqeve ne e kemi krijuar një mrekulli të vërtetë. Njeriu i cili është në gjendje të falë një, dy e deri në katër gjaqe, dhe jo vetëm t'i falë por edhe të krijojë miqësi dhe vëllazëri me dorasin, kjo është vërtetë vepër e madhe e Zotit dhe vepër e madhe e popullit. Në këtë mënyrë jemi pajtuar dhe jemi bashkuar, për çka krijuam parakushte për procese të reja

Po solidariteti, shëndetësia e shkolla?

- Hapi i dytë ishte bamirësia, sepse pjesa dërmuese e popullit kishte mbetur pa punë. Për këtë edhe e themeluam SHHBK "Nëna Tereze" duke u frymëzuar në jetën dhe veprën e saj për t'ua dalur në ndihmë të gjithëve. Mu për këtë populli shqiptar jetoj dhe mbijetoj me vite të tëra nga bamirësia dhe nga provania. Me këtë prekëm telin më të bukur e që ishte bujaria, ndarja e kafshatës së fundit në mes veti. Këtu duhet të përmendim të gjitha viset shqiptare e veçmas

diasporën tonë, e cila e morri me zemër këtë çështje. Kështu familjet e kurbetçarëve nuk dalloheshin nga ato të vendit. Nëpër mes bamirësisë kemi krijuar edhe afrinë duke kuptuar se e dhe e mira edhe e keqja është jona. Pra, si në ditët e mira e edhe në ditët e vështira duhet të jemi vëllezër. Me këtë kultivua marrdhëniet ndërnjerëzore të mos shikojmë njëri-tjetrin si të varfër apo të pasur, i shkolluar apo i pa shkolluar, i njohur apo i pa njohur në shoqëri, por të trajtojmë njeriun si qenie njerëzore, si krijesë e Zotit. Lëvizja e tretë ishte krijimi i institucioneve shëndetësore shqiptare paralele me ato të okupatorit. Lëvizja tjetër ishte për ta mbrojtur gjuhën dhe traditën tonë, kulturën dhe shkollën shqipe. Këtë e bënim me “Motrat Qiriazi”. Pra, qëllimi kryesor ishte që të mos e pranojmë sistemin, strukturën dhe planprogramet e Sërbisë, që defakto pranimi do ishte vetshkatrim jo vetëm gjuhës, shkollës por edhe vetshkatrim kulturor e shpirtëror yni.

Me këto tri lëvizje - eliminimin e vëllavrasjes, bamirësinë, shëndetësinë dhe shkollën shqipe, krijuam sistemin paralel, që në fakt praktikisht krijuam një shtet krijuam një pavarësi e një sistem të vetorganizimit, i cili dëshmoi para botës mbarë se jemi të aftë në çdo rrethanë të vetorganizohemi. Kjo edhe krijoi parakushte të strategjisë paqësore e jo dhunore, sepse në atë kohë nuk ishim në gjendje as të luftojmë, as të dorëzohemi e as ta pranojmë robërinë. Pra zgjedhëm strategjinë paqësore, e cila në botë bëri jehonë të madhe dhe ishte kjo ndër veprat e mëdha ku populli shprehu vetveten se jemi të gatshëm të vdesim e të vetflijohe mi, vetëm e vetëm që të mos shkaktojmë vetshkatrim dhe vetasgjësim. Të gjitha këto krijuan parakushte në rend të parë që të formohet LDK-ja si lëvizje gjithpopullore dhe pastaj të partive tjera deri në vitin 1999 kur ndodhi pa dëshirën tonë edhe lufta e armatosur e popullit shqiptar kundër okupatorit serb me në krye kryekriminelin Millosheviq. Atëherë bota e pa se një popull ndodhet para një shkatrimi e asgjësimi. Për këtë edhe ndërhyri faktori ndërkombëtar. Këtu në rend të parë ndikoi faktori i informimit shqiptar që ishte në nivel të lartë në Kosovë. Nëpërmjet informimit bota na njohu si paqësor, si bij dhe bija të Nënë Terezës, si njerëz që sakrifikohe mi për ruajtjen e identitetit tonë, si njerëz që flijohemi për të mbijetuar. Informimi ynë e mbi të gjitha ndihma e Zotit dhe përkrahja e ndërkombëtarëve, bëri që populli ynë t’i shpëtojë rrezikut të madh apo zhdukjes e dëbimit, që siç ndodhi në dy pranverat e shekullit të kaluar.

Çfarë mendoni për vitin e shenjtë shqiptar?

- Viti 2003 ishte vërtetë vit i bekuar dhe i shenjtë për shqiptarët i shpallur nga papa dhe Selia e Shenjtë, dhe vit i begatshëm për ne sepse siç dihet është përkujtuar 300-vjetori i Kuvendit të Arbënit (1703), me çka u përkujtua se ku ishim para 300-vjetësh, kur ishte edhe papa shqiptar - Papë Klimenti XI, apo siç është quajtur edhe papë Albani, pastaj u përkujtua se çka ka bërë kisha katolike shqiptare për ruajtjen e identitetit shqiptar, të fesë, të gjuhës, traditës, historisë, kulturës shqiptare etj., praktikisht i të gjitha atyre që quheshin shqiptarizëm. Në fakt u analizua krejt çka ishte dhe kishte atëherë për të mësuar se historia është mësuësja e jetës. Në ato rrethana Kuvendi i Arbënit paraqiste një rrezistencë të fuqishme dhe një analizë të gjithmbarshme se kush ishim dhe kush jemi, e që kishte për qëllim mbrojtjen e identitetit për t’iu kthyer të vërtetës dhe vetvetes, për të mësuar nga historia për të djeshmen, të sotmen e sidomod për ardhmërinë, sepse kush nuk ka histori ai faktikisht nuk ka as ardhmëri.

Të mendojmë shumë herë para se të veprojmë

Po, ku jemi sot?

- Mendoj se jemi në rrugë të mirë, sepse pafajësia e popullit që ka pësuar me shekuj e edhe në kohën e afërt ku ende e edhe sot nuk dihen varret e njerëzve të zhdukur, që shpesh herë janë të zhdukur edhe në mendje dhe zemrat tona e jo vetëm në varrezat masive dhe të panjohura. Pak kemi bërë ne e edhe ndërkombëtarët për fatin e të zhdukurve.

Tjetër, integrimi i ynë shqiptar për të trajtuar çështjet tona vëllazërisht e bashkarisht dhe për të kërkuar rrugën sa më të shkurtër deri të caku përfundimtar i lirisë dhe i pavarësisë së plotë.

Mendoj se ndërkombëtarët bëjnë eksperimente me ne dhe dëshirojnë të na standardizojnë.

Megjithatë, unë nuk i shoh keq standardet që kërkohen, sepse këto standarde janë një lloj parakushti që të hyjmë në familjen e madhe evropiane ku edhe e kemi vendin. Por pyes vetveten se çfarë standardesh plotësojmë ne si shqiptar, e jemi të vetdijësuar, të orientuar, dhe të përcaktuar që vërtetë të jemi të lirë në mënyrë të mirë që t'i dëshmojmë botës edhe njëherësh se kemi merituar ndërhyrjen e tyre, përkrahjen dhe praninë e tyre, por meritojmë si gjithë popujt e tjerë të drejtën e vetvendosjes.

Ndërkombëtarët në qarqet e larta për aq sa vlerësojnë unë, ende kanë nderin dhe admirimin për gjithë atë që ka ndodhur historikisht dhe aktualisht. Ata edhe i gëzohen çdo suksesi tonë dhe dëshirojnë të na ndihmojnë. Ndërkaq, te shtresat e mesme dhe të ulta ndërkombëtare ka filluar një llojë ftohjeje, sepse shpesh nga sjelljet tona ata hutohen dhe bëjnë pyetje se çka dojnë këta njerëz. Prandaj, çdo shqiptar, që nga ata të politikës, të shkencës, të kulturës dhe të artit, prej institucioneve më ta larta që i kemi, që të gjithë duhet të mendojmë shumë herë para se të veprojmë. Njëherësh, duhet t'i gjejmë format për një bashkim vëllazëror, për një bashkpunim më dinamik me bashkësinë ndërkombëtare, se vetëm me këta faktorë, por edhe me ndihmë e Zotit ne mund t'ia dalim që t'i realizojmë të gjitha synimet tona, që të jemi vetvehtja, por pa u a mohuar të tjerëve që edhe ata të jenë vetvehtja.

Frrok Kristaj "Ambasador i kulturës shqiptare", Rilindja, Prishtinë

Në foto: Don Lushi anëtarë i Akademisë Evropiane

Dr. don LUSH GJERGJI

VËLLEZËRIA JONË E DYFISHTË ËSHTË UNIKATE NË BOTË

Jemi të lirë aq sa jemi të mirë dhe liria jonë është e dyfishtë: e dhuruar, së pari prej Zotit, dhe e ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare, dhe e fituar me pjesëmarrjen dhe aktivizimin tonë. Megjithatë, ende na mungon kultivimi i kulturës së jetës. Pak investojmë në njeriun, që është bazë për krijimin dhe formimin e familjes dhe të shoqërisë. Po ashtu, na mungon ndjenja e përkatësisë, jeta institucionale, përgjegjësia dhe angazhimi për të mirën tonë të përbashkët. Ne ose jemi individualista të tepruar, në stilin e bajraktarizmit, ose jetojmë nën ndikimin e turmës, në mënyrë që t'i ikim përgjegjësisë. Në 1700-vjetorin e lirisë fetare nga paraardhësi ynë Perandori Konstandini i Madh - shugurohet Katedralja në Prishtinë

Ditë më parë zhvilluam një intervistë me dr. don Lush Gjergjin, vikar gjeneral në Ipeshkvinë e Kosovës dhe kryeredaktor i revistës DRITA si dhe e së njëjtës shtëpi botuese, me ç'rast biseduam për shumëçka që ka të bëjë me jetën tonë dhe aktualitetin tonë politikë e shoqëror në Kosovën e pas luftës, por edhe për të arriturat në Republikën e Kosovës.

Ku ishim dhe ku arritem - cilat janë ndryshimet në Kosovë?

- Ndryshimet janë të shumfishta dhe të llojllojshme pas dymbdhjetë vjetve të luftës dhe të lirisë, të zhvillimeve demokratike. Së pari gjatë këtyre viteve ka pasur një dinamizëm mjaft i hovshëm, do të thoja një lloj “vrapimi” për ta “zënë” kohën e humbur, vitet e mungesës së lirisë dhe të pavarësisë, në aspektin ekonomik, politik, shoqëror, deri diku edhe kulturor.

Krahasimi me botën, veçmas me Evropën dhe Amerikën, ka krijuar tek ne ndjenjën e “vonesës”, mos të them të “prapambeturisë”, dhe kjo ka shkaktuar dhe ende shkakton ethe, përsheptim dhe ngutësi, sidomos lakmi në lëmin ekonomik. Sot Kosova ka një dukje apo pamje tjetër, gjithkund është punuar dhe ndërtuar, veçmas në sektorin privat, por edhe atë publik, si rrugët, ujësjellsi, kanalizimi, shkolla, spitale, dhe kjo tashmë nuk ka të ndalur. Janë ndërtuar shumë shtëpi, qendra tregtare, vendbanime të reja dhe kjo është mjaft pozitive.

Mirëpo, në anën tjetër jemi ende mjaft prapa në punësim, mbi të gjitha në begatimin tonë kulturor dhe shpirtëror, në investime në njeriun, në mirëvajtjen e familjes dhe të shoqërisë. Unë kam thënë disa herë, dhe po e përsëris porosinë time: Jemi të lirë aq sa jemi të mirë dhe liria jonë është e dyfishtë: e dhuruar, së pari prej vetë Zotit, dhe ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare, dhe e fituar me pjesëmarrjen dhe aktivizimin tonë. Pjesa e parë tashmë është kryer, ndërsa ajo e dyta, mbetet gjithnjë detyrë, edhe më tepër, mision për t'u përplotësuar dhe proces për të vazhduar.

Gjendja ekonomike, varfëria, papunësia, deri diku edhe mungesa e perspektivës, ka shkaktuar ndoshta egoizëm të tepruar, indiferentizëm për njëri-tjetrin, ftofje në marrëdhëniet ndërnjerëzore, familjare, vrapim frenetik rreth pasurimit material dhe financiar me çdo kusht, edhe duke shkelur apo nënçmuar, shpesh edhe duke shfrytëzuar njëri-tjetrin. Ky lloj "kapitalizmi i egërt", i cili nuk njihet më asgjë dhe askënd përpos paranë, pasurinë, mirëqenien, është i rrezikshëm dhe pa i shpirt, pa vlera dhe virtyte, pa të cilat nuk ka përparim të gjithëmbarshtëm.

Në një gjendje të tillë, kuptohet, të vegjëlit ose të dobët, siç janë të papunët, të sëmurët, gratë, përgjithësisht bota femrore, fëmijë, rinia, më tepër pësojnë se jetojnë, sepse garimi i tillë ata i anëson, shpesh edhe i përjashton.

Po ashtu shkenca, kultura, arti, familja, shkollimi, qytetërimi, shëndetësia, janë disi të lëna pasdore, sepse kanë nevojë për mjete të mëdha dhe hë për hë nuk "japin fryte". Pra, sipas mendimit tim ende na mungon kultivimi i kulturës së jetës dhe i qytetërimit e i dashurisë, ku vend të spikatur duhet të kenë shi ato kategori që tashmë tek ne janë të rrezikuara - fëmijë, rinia, bota femrore, të sëmurët dhe të moshuarit. Më duket se pak investojmë në njeriun, në vlera të mirëfillta dhe virtyte themelore dhe jetësore, e mos të harrojmë se njeriu gjithnjë dhe gjithkund është elementi bazë për krijimin dhe formimin e familjes dhe të shoqërisë.

Gjatë periudhës së pasluftës, shqiptarët u larguan në mes veti apo u ofruan?

- Ne si duket më tepër na afron dhe bashkon vuajtja, sfida, rrezikimi, robëria, se liria, bashkëpunimi, sepse na mungon ndjenja e përkatësisë së përbashkët, jeta institucionale, përgjegjësia dhe angazhimi për të mirën tonë të përbashkët. Shi për këtë kemi halle dhe vështirësi në rrethana të reja për bashkëpunim dhe planifikim, sepse ose jemi individualista të tepruar, në stilin e bajraktarizmit, ose nën ndikimin e mentalitetit turmor apo grumbullor, pra, anonim, pa kujdes dhe motivim për gjërat të përbashkëta, shkrihem në masë për t'i ikur çdo lloji përgjegjësie. Na nevojitet ende shumë punë, përvojë dhe vetëdije për formimin e ndjenjës së përgjegjësive dhe të lirisë, parakusht themelor për bashkëpunim institucional.

Po identiteti kombëtar dhe ai fetar a është luhatur?

- Identiteti ynë kombëtar ndoshta sadopak është dobësuar, sepse tashmë nuk jemi të rrezikuar si shqiptarë, ndoshta edhe me një ndikim të pranishëm ndërkombëtar në Kosovë. Disa shkojnë aq larg sa që përkrahin një lloj identiteti të ri kombëtar "kosovar", duke ngatërruar çështjen kombëtare shqiptare, me atë shtetërore - Republika e Kosovës. "Tollovia" e tillë krijon vetëm mjegullim, huti, paqartësi, dhe si e tillë e dëmton edhe çështjen kombëtare shqiptare, edhe atë shtetërore - Republikën e Kosovës. Këtu vlen parimi i vjetër latin: Mëson mirë kush dallon mirë! Identiteti ynë fetar është një gërshetim mes asaj të vjetrës, të krishterë qysh nga koha apostolike, dhe të mëvonshmes, islamizimit të popullit shqiptar, kuptohen nën ndikimin dhe sundimin shekullor turko-otoman. Sot de facto jemi edhe të krishterë edhe myslimanë, mbi të gjitha jemi

vëllazërisht shqiptarë, ana kombëtare, dhe jemi besimtarë, monoteistë, të krishterë dhe myslimanë, ana fetare.

Kjo vëllazëri e dyfishtë është mjaft e rrallë, mos të them unikale në botë, të cilën duhet ta njohim, ta pranojmë, ta begatojmë me dialogun ndërfaqësor krishtero-mysliman në lëmitë e ndryshme të jetës dhe veprimtarive të bashkësive tona fetare dhe në të mirë me dobi të të gjithë qytetarëve.

Kush e do dhe nderon Zotin, Atin tonë të përbashkët, doemos e do edhe të afërmin, vëlla apo motër, dhe dëshmon bindshëm se feja jo vetëm që nuk përçanë, por afron dhe krijon bashkimin në dallime.

Çfarë është sot vlerësimi (te shqiptarë) për Nënë Tereze, përkatësisht për Gjergj Kastriotin?

- Këto dy figura janë në një mënyrë personalitetet që na përfaqësojnë në botë, spikasin me vlera dhe virtyte për të cilat ka nevojë çdo shqiptar. Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, që me largëpamësi, strategji, vizion, urtësi, ndjenë politike dhe shtetërore i ka bashkuar principatet shqiptare në luftë kundër sundimit turko-otoman dhe e ka mbrojtur heroikisht lirinë dhe autoktoninë tonë shqiptare. Nëna Tereze e cila me mirësi dhe dashuri e ka "pushtuar" mbarë njerëzimin, dhe me fuqinë e fesë dhe frymëzimit e dashurisë ka dëshmuar se asgjë nuk është e pamundshme për atë që beson dhe dashuron. Ajo është shprehja më e bukur e dashurisë së krishterë dymijëvjeçare për vëllaun - njeri, dhe njëkohësisht edhe e traditës sonë shqiptare për bamirësi, bujari, mikpritje, përkujdesje për nevojtarë.

Tash kur u lumturua Papa Pali II (Karol Vojtila), a konsiderohet pozicioni i tij ende mik i shqiptarëve?

- Papa Pali II ishte mik tejet i madh dhe i dalluar për mbarë shqiptarët, në veçanti për Kosovën. Në fakt, pa Nënë Tereze, kuptohet nëpërmjet Imzot Nikë Prelës (1918-1996), nëpërmjet saj pa Gjon Palin II, dhe kontributin e çmuar të Presidentit dr. Ibrahim Rugovës, mendoj se kurrë për çështjen e Kosovës nuk do të lëvizte Amerika, e nëpërmjet saj, edhe më pak Evropa. Historia do ta dëshmojë këtë binom: Papa Gjon Pali II - Nëna Tereze ishin "shpëtimtarët" tanë para Zotit dhe para bashkësisë ndërkombëtare, kuptohet, edhe me pjesëmarrjen dhe flijimin tonë.

Si po zhvillohen punimet në përfundimin e Katedrales në Prishtinë?

- Puna vazhdon me ritmin e rëndomtë. E rëndësishme është që kemi arritur me ndihmën e Zotit, me përkrahjen e të gjithë shqiptarëve pa dallime shtetesh nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, diaspora shqiptare në Evropë dhe në SHBA, pa dallime feje, të krishterë, myslimanë angostikë, mos të them të "pafe", që më 5 shtator 2010, në 100-vjetorin e lindjes së Nënës Tereze, ta kremtojmë edhe Meshën e Parë në Katedralen e saj dhe tonë "Nëna Tereze" në Prishtinë.

Kjo ishte edhe dëshira, në një mënyrë edhe premtimi dhe "amaneti" i Imzot Mark Sopit, ipeshkvit tonë të ndjerë, dhe dr. Ibrahim Rugovës, me rastin e bekimit të gurthemelit të Katedrales.

Tash e kemi një rast vërtet unik - 1700-vjetorin e Ediktit të Milanos, dekretit të lirisë fetare të krishterë në Perandorinë Romake, nga një paraadhës ynë, figurë me dimensione dhe domethënie botërore - Perandori Konstandini i Madh. Shpresojmë në Zotin se do të gjejmë mjete dhe bamirës për ta shuguruar Katedralen në Prishtinë. E them këtë sepse Katedralen po e ngrisim me ndjenja

dhe me zemër, ndaj edhe bekimi dhe shukurimi - kushtimi i saj do të ishte kurorëzim i madh i këtij jubileu vërtet domethënës për ne dhe për mbarë botën, në vitin e Zotit 2013.

Ne punojmë dhe gjithnjë shpresojmë, e Zoti i cili deri në këtë pikë na ka ndihmuar dhe na ka përcjellur mrekullisht, do të jetë me ne!

Frrok Kristaj "Vëllezëria jonë e dyfishtë është unikate në botë", Bota sot, Prishtinë, 27 maj 2011, faqe 12

Në Foto: Don Lushi duke folur në Simpoziumin kushtuar Perandorit dardan Konstandinit të Madh në Prishtinë

VEPRAT E FRROK M. KRISTAJT

ISHULLI I PRITJES (poezi), "Rilindja", Prishtinë, 1978

ASHTI YNË FERISHTE NË GUR (poezi), SHB "Anton Pashku", Prishtinë, 2004

NËNA-NJESË (poezi për fëmijë), ShKK "Anton Pashku", Prishtinë, 2010

NJERIU I PENËS DHE I ARMËS (me bashkautor S. Zogaj), KL "Sh. Gjeçovi", Zym, 1980

SHTETËSIA E KOSOVËS (me bashkautor K. Devaja), PSHDK, Prishtinë, 1995

ANTON PASHKU - GJENIU I MODERNES SHB "A. Pashku" - Prishtinë e KL "A. Pashku", Kukës, 2005

GALDIME SHPIRTËRORE (etnografi e folklor), KL "Shtjefën Gjeçovit", Zym, 2011

TROJET E SHQIPEVE I (tekst-test me bashkautor M. Reçica), KSHA, Rottweil (Gjermani), 1993

TROJET E SHQIPEVE II (tekst-test), KASH, Wuppertal (Gjermani), 1997

PËRSHËNDËTJE VENDLINDJES (monografi), KSH "Kosova", Hamburg (Gjermani), 1988

SOFRA E NËNËS (monografi), SHHBK "Nëna Tereze", Prishtinë, 2000

KATARINA JOSIPI - KATI (monografi), SHB "Anton Pashku", Prishtinë, 2004

SHKA "KATARINA JOSIPI" (me bashkautor), SHKA "K. Josipi", Zym, 2005

IMZOT NIKË PRELA (monografi), Shoqata HEKAS "Nikë Prela", Ferizaj, 2006

MËSUESI GJON (monografi), ShKK "Anton Pashku", Prishtinë, 2007

ZYMI I HASIT (fletëpalesë me bashkautor N. Kërhanaj), KL "Sh. Gjeçovi", Zym, 1996

TAKIMET E GJEÇOVIT 1971-2006 (monografi), KL "Sh. Gjeçovi", Zym, 2007

JUSTINIANI DARDAN - PERANDOR I BIZANTIT (fletëpalesë), ShKK "Anton Pashku", Prishtinë, 2008

URA E KUJTESËS (udhëshkrime), ShKK "Anton Pashku", Prishtinë, 2008

RILINDJA - ABETARE E GAZETARISË (monografi), Gazeta "Rilindja", Prishtinë, 2009

SAFETE ROGOVA - AKTORE, VEPRIMTARE E HUMANISTE (monografi), RrGGK, Prishtinë, 2011

ZYMI I HASIT - GUIDË TURISTIKE (shqip-anglisht), Famullia Zoja e Hasit, Zym, 2011

GJURMË TË GJEÇOVIT 2001

GJURMË TË GJEÇOVIT 2002

GJURMË TË GJEÇOVIT 2003-2004

GJURMË TË GJEÇOVIT 2005-2007

TAKIMET E GJEÇOVIT 2007

TAKIMET E GJEÇOVIT 2009

TAKIMET E GJEÇOVIT 2010

TAKIMET E GJEÇOVIT 2011

Errok KRISTAJ
ARTI I DIALOGUT
(Intervista me dr. don Lush Gjergjin)

Lektor
Ajete ZOGAJ

Disenji

Tirazhi
500 copë

U shtyp në shtypshkronjën

Prishtinë
2013

Falenderim
Autori e falenderon Drejtoratin e Kulturës të komunës së Prishtinës
për mbështetje materiale për botimin e këtij libri

FJALA E REDAKTORIT

(Për librin “ARTI I DIALOGUT” (Intervista me dr. don Lush Gjergjin) të Frrok Kristajt)

Frrok Kristaj, në cilësinë e gazetarit shumëvjeçar, ka kuktivuar me ngulm zhanrin e intervistës me njerëz e personalitete të dalluara të jetës sonë kulturore, artistike, diturore, politike, arsimore etj. Intervista e tillë, na shfaqet mjeshtërore edhe te vëllimi: “ARTI I DIALOGUT” (Intervista me dr. don Lush Gjergjin), në të cilin jo vetëm që i përmbush kriteret e profesionalizmit të mirëfilltë, por merr rolin edhe të një kronike të gjallë të kohëve, shndërrohet në një bashkëbisedues dinamik për proceset në fushat e kulturës, veçanërisht, dhe të jetës shoqërore përgjithësisht. Shndërrohet në një zë intelektual, që e drejton gishtin kah thelbet e qenies sonë, dhe që i jep rrugëzgjdhjet për të dalë nga qorrsoakaku ku futen fenomenet a dukuritë e tilla në fushat përkatëse.

Gjithsesi, që intervistat ngërthejnë edhe ngjyrimin thellësisht racional, në gërshet me ngjyrimin emocional, gjithë temperament e gjithë intelekt, të shprehjes së mendimit subjektiv për ta kumtuar të vërtetën apo për ta sqaruar një fenomen. Intervistat-model nuk i mungojnë letrave shqipe, duke i paraqitur në mënyrë kreative, përmes intervistimit, kujtimet, krijimtarinë dhe jetën të të intervistuarit (aktorë, shkrimtarë, pedagogë, shkencëtarë etj).

Nëpërmjet intervistës zgjohet Muza e Kuvendimit a e oratorisë së bashkëbisedimit: ai bashkëbisedon nën shenjën e Polimnisë, muzës së Këngës së Përshpirtshme, Oratorisë dhe retorikës. Nëpërmjet kësaj muze ai i paraqet kërshëritë, bindjet, përvojat intelektuale, kulturore, morale, sociale dhe kombëtare. Intervistat e tilla, nëpër dekada, e ruajnë vlerën e tyre kulturore, e ruajnë frymën e kohës, me animet, simpatitë e antipatitë; me angazhimet intelektuale e krijuese dhe me argumentimin racional të lëndës së intervistuar. Do theksuar se libri merr vlerë me përkushtimin në 1700-vjetorin e legalizimit të krishterimit, me të cilën ngjarje botërore ndërlihet njëra ndër figurat qendrore të qytetërimit botëror, ajo e Konstandinit të Madh. Së këndejmi, intervista kanë vlerën e tyre jashtë kontekstit teologjik dhe marrin vlerë të pranueshme për kulturën shqiptare dhe më gjerë.

Prend BUZHALA

(Në kopertinën e pasme)